



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### *Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.05.2020, ora 09:00

**Drejton mbledhjen:**

**Niko Peleshi – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

1. Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar””. *(Komision për dhënie mendimi)*
2. Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar””. *(Komision për dhënie mendimi)*
3. Projektligji “Për përmirësimin e zonave të biznesit (BID)”. *(Komision për dhënie mendimi)*

#### **Marrin pjesë:**

Niko Peleshi, Besnik Baraj, Robert Bitri, Eglantina Gjermani, Tatiana Pirro, Arben Pellumbi, Kujtim Gjuzi, Nimet Musaj, Arlind Çaçani, Andrea Marto, Ardit Konomi, Ilir Ndraxhi, Ilir Beqaj, Fadil Nasufi, Halit Valteri dhe Zef Shtjefni.

#### **Mungojnë:**

Gjetan Gjetani, Rrahman Rraja, Lefter Koka dhe Klajdi Qama.

#### **Të ftuar:**

Vasilika Vjero - Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Nikolla Lero - Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Adrian Kamenica - Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

Redi Baduni – Drejtor në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit

Belinda Ikononi - Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Arvid Uruçi - Përfaqësues i Drejtorisë Juridike në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Ridvan Troashani – Përfaqësues i Fondacionit Shqiptaro- Amerikan për Zhvillimin

Ekflodia Leskaj - Përfaqësuese e Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillimin

Ardjana Sheti - Juriste në Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillimin

## HAPET MBLEDHJA

**Niko Peleshi** - Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Veprimtarisë Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit, të datës 5 maj 2020, ora 09:05.

Së pari, dua ta filloj mbledhjen me një urim për ditën e sotme, 5 Maj, që është Dita e Dëshmorëve. Qoftë i përjetshëm kujtimi i dëshmorëve të vendit tonë!

Ju kërkohet ndjesë, pasi një pjesë juaja do të merrte pjesë në ceremoni, por grafiku, siç e dini edhe për shkak të situatës, nuk është gjithmonë në dorën tonë, kështu që jemi të detyruar ta zhvillojmë mbledhjen në këtë orar!

Një pjesë e kolegëve do të na bashkohen pak më vonë, sepse kanë qenë të ngarkuar për të përfaqësuar edhe kolegët e tjerë në ceremoninë përkujtimore të 5 Majit.

Po ashtu, kam një urim tjetër, përsëri në emër të të gjithë anëtarëve të komisionit, për kolegun tonë Dritan Bici, i cili ka ditëlindjen sot.

**Dritan Bici** – Faleminderit, kryetar!

**Niko Peleshi** – Gëzuar ditëlindjen dhe shumë vite të tjera të lumtura!

**Dritan Bici** – Faleminderit!

Fillojmë mbledhjen e komisionit, sipas rendit të ditës që po ju lexoj, pasi në total kemi tre projektligje. Projektligji i parë “Për një shtesë në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar””, projektligji i dytë “Për një shtesë në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”” dhe projektligji i tretë “Për përmirësimin e zonave të biznesit (BID)”.

Fillojmë me projektligjin e parë, por dua t’ju theksoj se për dy projektligjet e para relator është zoti Arben Pëllumbi. Të ftuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit janë zoti Adrian Kamenica, sekretar i Përgjithshëm dhe zoti Redi Baduni. Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë të ftuar janë zëvendësministrja Vasilika Vjero.

Përshëndetje, zonja Vjero!

**Vasilika Vjero** - Përshëndetje!

**Niko Peleshi**—Si dhe zoti Nikolla Lera, të cilin nuk e di nëse është në linjë apo jo.

Zoti relator, a mund të fillojmë me një prezantim nga zoti Kamenica?

**Arben Pëllumbi** – Po.

**Niko Peleshi** – Zoti Kamenica, ju lutem, një prezantim të projektligjit!

Zoti Gjuzi, e keni kërkuar fjalën?

**Kujtim Gjuzi** – E kisha kërkuar fjalën para se ta fillonim zyrtarisht mbledhjen, nëse më lejoni!

**Niko Peleshi** – Urdhëroni!

Mbledhja ka filluar zyrtarisht, por nuk ka problem.

**Kujtim Gjuzi** – Para se të fillonim me shtjellimin e çështjeve të rendit të ditës, në radhë të parë dua t’ju falënderoj për organizimin me kompetencë të Komisionit të Veprimtarisë Prodhuese, për atë kohë sa unë jam anëtar i tij, pasi për dy ditë bëj 1 vit në Kuvendin e Shqipërisë.

Meqenëse po na ndjekin live shumë shqiptarë, do të doja të më lejonit të jap shpjegimet e votës në pak sekonda. Është e vërtetë që gjatë 1 viti kam votuar kundër, kryesisht abstenim në masën më të madhe, por edhe pro, se Komisioni i Veprimtarisë Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit nëse nuk do të kishte kuorum, pra edhe deputetët e opozitës, nuk do të funksiononte, si dhe nuk do të funksiononin mjaft ligje që do t’i jepnin përkrahje biznesit apo të çështjeve të tjera.

Mendoj se shqiptarët duhet ta konceptojnë, pavarësisht se jam totalisht kundër politikave të qeverisë “Rama 3”, se votat e mia kanë qenë në një farë mënyre, pikërisht se në krye të këtij komisioni keni qenë ju, zoti Niko Peleshi. E theksoj këtë jo për të qenë solidar me ju në koncept, por për të qenë solidar me atë që themi, se në Shqipëri duhet të ketë shtet të së drejtës. Nëse e majta ka të drejtë për një projektligj, vota e Kujtim Gjuzit do të jetë pro, nëse e majta ose Kujtim Gjuzi nuk do të jetë i bindur për votën pro në projektligje të ndryshme, vota ime do të jetë abstenim; nëse e majta sjell këtu para që inkasohen në arkën e shtetit shqiptar si pasojë e marrëveshjeve bilaterale ose makro, kryesisht me aleancën e shtetit dhe Aleancën e Atlantikut, e theksoj, vota ime do të jetë karton jeshil që të kalojnë paratë. Unë jam ekonomist dhe përfaqësues i Komisionit të Veprimtarisë Prodhuese, i cili u hap dritën jeshile të gjitha bizneseve, prandaj shqiptarët duhet ta kuptojnë këtë. A kam unë kundërshti për Ramën?

Le ta vazhdojmë mbledhjen dhe ju falënderoj, zoti kryetar!

**Niko Peleshi** – Faleminderit, zoti Gjuzi!

Zoti Kamenica, ju lutem, prezantimin e projektligjit!

**Adrian Kamenica** – Faleminderit!

Zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Ju falënderoj për mundësinë që na jepni për ta prezantuar këtë projektligj të ri “Për një shtesë në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar””. Është një incentivë që dëshirojmë ta ndërmarrim në kuadër të zhvillimit të një potenciali të ri të sektorit të turizmit, siç është industria e detit, një industri që deri më sot nuk ka qenë e zhvilluar fare. Pra, jo thjesht nuk ka qenë e zhvilluar, por duke e konsideruar edhe pozicionin gjeografik dhe strategjik të Shqipërisë në Mesdhe, ka qenë një industri që ka penguar madje edhe zhvillimin dhe vendi ynë ka qenë në një farë mënyre indirekt vuajtësi i zhvillimit të kësaj industrie në të gjithë Mesdheut.

E kam pak të vështirë, por do të doja t’ju paraqisja disa grafikë. Kjo këtu është harta e industrive të jahteve në të gjithë rajonin, ku Italia ka 142 mijë vende, Kroacia ka rreth 17 mijë vende jahtesh, Greqia 20 mijë vende jahtesh, ndërsa Shqipëria ka zero vende jahtesh. Po ashtu, kjo është një hartë që sapo e printova tani nga portali *online* Marin Traffic...

**Niko Peleshi** – Adrian, më falni, nëse këto materiale i keni edhe elektronikisht, mund t’i bëni *share* që t’i shohin më qartë edhe kolegët!

**Adrian Kamenica** – Nëse doni, mund t’i ndaj dhe t’jua dërgoj.

**Niko Peleshi** – Nuk ka problem, por mendova meqë po përpiqeshit ta ekspozonit...

**Adrian Kamenica** – Thjesht doja të qartësoja rëndësinë e kësaj industrie dhe faktin se Shqipëria aktualisht është zero në këtë industri, nuk ka asnjë lloj incentive. Kjo është një industri mjaft e madhe dhe ka një vlerë diku te 15 trilionë dollarë në gjithë botën, është industria e detit në të gjithë botën, ku edhe ne nga ana jonë duhet ta zhvillojmë. Ne, që nga viti 2014 afërsisht, kemi filluar përherë ta konsideronim si potencial industrinë e detit, duke ndërmarrë shumë studime që janë përkrahur nga qeveria gjermane, qeveria italiane, por ende edhe sot kemi parë mundësinë e bashkëpunimit me shumë partnerë, sidomos së fundi me partnerët nga Monako apo nga Malta.

Për momentin kemi arritur një emërues të përbashkët që kjo industri në Shqipëri duhet të fillojë të zhvillohet. Problemi i moszhvillimit të kësaj industrie deri tani ka qenë për disa arsye, por arsyeja kryesore ka qenë që deri më sot deti është konsideruar jo si një potencial ekonomik, pra në një farë mënyre ne e kemi penguar zhvillimin e industrisë së detit për arsye dhe qëllime legjitime dhe të justifikueshme. Që sot e tutje mendoj se duhet ta shohim detin si një potencial ekonomik jo vetëm për zhvillimin e industrisë vendase, por edhe për vendosjen e Shqipërisë në

një hartë rajonale të industrisë detare, si dhe përfitim qe do të ketë Shqipëria nga e gjithë kjo iniciativë globale.

Është e rëndësishme t'ju them se nga studimet tona, fillimisht kemi menduar se do të ishte më e rëndësishme hapja e një porti jahtesh dhe më pas gradualisht të vinin anijet e jahtet. E kemi trajtuar shumë herë me këmbëngulje këtë lloj përjasjeje, por për ne deri tani nuk ka rezultuar shumë e suksesshme, për faktin kryesor se portet e jahteve kanë një investim kapital shumë të madh, afërsisht për 1 mijë vende jahtesh duhen diku te 30-40 milionë euro investim, të cilat në një farë mënyre për disa vite duhet të kthehen.

Tani jemi në mes të dilemës nëse duhen portet e jahteve në fillim apo vetë jahtet, vetë aktiviteti? Ajo që po përpiqemi të incentivojmë me anë të këtij projektligji, që kemi sjell sot për miratim në Kuvend, është pikërisht fakti se kjo gjë do të na marrë shumë vite apo ndoshta investitorët do të na kërkojnë shumë vite derisa të binden për të vijuar investimin në portet e jahteve, meqenëse kërkohet një kapital i madh.

Rrjedhimisht, është e domosdoshme që ne të gjejmë çdo mënyrë për incentivimin e kësaj industrie, të aktivitetit të jahteve dhe të turizmit detar. Për këtë qëllim kemi ndërmarrë këtë iniciativë dhe pretendojmë se do të ketë zero efekt negativ në buxhet, përderisa momentalisht në vendin tonë nuk janë importuar jahte këto vitet e fundit. Ajo që ne pretendojnë të bëjmë është të krijojmë një incentivë të tillë fiskale nëpërmjet së cilës Shqipëria do të jetë në gjendje të prezantojë një paketë të re incentiveuse, për regjistrimin e sa më shumë jahteve në vendin tonë, me pak fjalë për krijimin e të ashtuquajturit “Flamuri shqiptar”.

Nga studimet tona kemi parë se incentiva të tilla ekzistojnë në të gjithë rajonin. Disa nga shembuj e fundit rajonal që ne kemi momentalisht janë: Mali i Zi e ka tatim-fitimin 9%, ku ka 0% TVSH për udhëtimin me charter, ka 7% TVSH për investime të tjera dhe zero TVSH për karburantin. Po ashtu, Greqia ka zero tatim-fitimi në përgjithësi, ku për jahtet komerciale e ka zero TVSH-në, për karburantin e ka zero TVSH-në dhe për dhënien me qira e ka 12%. Malta e ka 5,4% TVSH-në, për jahtet komerciale e ka zero TVSH-në e kështu me radhë.

Pra, janë një sërë incentivash që ne i kemi analizuar në detaje nga të gjitha rajonet dhe kemi parë se kjo është një industri shumë konkurruese dhe kërkon një paketë të mirë për t'u futur në treg. Ne e kemi potencialin gjeostrategjik, potencialin e dëshirës për ta zhvilluar, si dhe të vendndodhjes ku jemi, për ta zhvilluar këtë sektor, por ajo që na duhet për të shtuar janë disa incentiva në mënyrë që të kemi mundësinë ta promovojmë këtë industri ashtu siç duhet.

Për këtë qëllim kemi arritur në një propozim të tillë për të hequr TVSH-në momentalisht për jahtet, jo më të vjetra se 20 vjet. Këtu po kujdesemi që në Shqipëri të formohet një flotë e re e jahteve, jo të vjetra, për të shkatërruar ambientin, por përkundrazi të jenë jahte, të cilat do të jenë operative dhe do të kenë mundësi të aktivizohen në të gjithë rajonin.

**Niko Peleshi** –Adrian, faleminderit për prezantimin e detajuar!

Zoti Pëllumbi, si relator fjala për ju.

**Arben Pëllumbi** – Faleminderit, kryetar!

Në fakt, nuk do të ndalem gjatë, pasi kolegu foli në mënyrë të detajuar për projektligjin, kështu që synimet dhe qëllimet e tij janë tashmë të qarta. Pra, synohet zhvillimi i një industrie, të cilën ne sot nuk e kemi, pavarësisht përpjekjeve që janë bërë deri në këtë moment. Është një pjesë, nëse shohim gjithë bregdetin e detit Adriatik dhe të detit Jon, ku vetëm Shqipëria është e vetmja që nuk ka harta treguese në lidhje me jahtet, ndërkohë që Kroacia, Mali i Zi dhe Greqia janë pothuajse të mirorganizuara në këtë aspekt.

Këtë propozim që na ka ardhur e shoh si një ndihmesë të madhe, e cila mund të çojë në zhvillimin e kësaj industrie. Sigurisht nuk duhet të jetë e vetme, por të shoqërohet edhe me hapa të tjera, sepse nuk besoj se ka qenë vetëm çështja e çmimit. Në fakt, ulja e TVSH-së ndikon drejtpërdrejtë në çmimin e këtyre mjeteve, por nuk besoj se do të jetë vetëm kjo ajo çka do të sjellë një zhvillim të kësaj fushe dhe të kësaj industrie.

Dakordësoj me ministrinë në lidhje edhe me hapat e tjerë që janë ndërmarrë deri tani, por sikurse u vu re edhe nga shpjegimet që u dhanë, vendet rreth e rrotull nuk e kanë TVSH-në vetëm në blerje, prandaj duhet të fillojmë të mendojmë edhe për atë të karburanteve apo të shërbimeve të tjera që duhen dhënë në raport me këto mjete.

Gjithsesi, industria e detit, e cila në përgjithësi tek ne mungon, nuk ka vetëm sektorin e jahteve, por ka edhe sektorin e argëtimit në det, i cili mungon, por duke qenë se turizmi është një sektor, të cilin po e zhvillojmë, pavarësisht situatave në të cilat ndodhemi dhe se si mund të shkojë kjo verë, turizmi do të ngelet gjithmonë një sektor prioritar. Për këtë arsye, përveç gjithë anëve të tjera, mendoj se argëtimi në det është një anë shumë e rëndësishme, besoj se të gjithë e kanë vënë re që kjo pjesë pothuajse mungon.

Doja t'ju pyesja, në këtë projektligj parashikohet ulja e TVSH-së vetëm për jahtet apo për të gjitha mjetet argëtuese, të cilat prodhojnë biznes dhe punësim në det.

Projektligji vjen në përputhje të plotë me Rregulloren e Kuvendit dhe duke qenë se nxit një veprimtari të caktuar dhe punësimin, për ne si Komision i Veprimtarive Prodhuese duhet të jetë një element që duhet ta mbështesim dhe ta votojmë.

Faleminderit!

**Niko Peleshi** – Faleminderit, zoti Pëllumbi!

Zoti Gjuzi, keni kërkuar fjalën?

**Kujtim Gjuzi** – Faleminderit!

I falënderoj kolegët për këtë projektligj të munguar prej kohësh, por siç thuhet në Shkodër, asnjëherë nuk është vonë!

Pyetja ime do të ishte për relatorin, zotin Pëllumbi: si i parashikon ai ambientet apo ato pjesë portuale që do të ndërtohen për jahtet, sa dhe si është sasia?

Pyetja e dytë është: për çfarë arsye u bllokua Porti i Shëngjinit dhe nuk shkoi në atë destinacion, që qytetarët e Dardanisë dhe të Kosovës të vinin dhe ta kishin si port të vetin, me atë që quhet zona *free*/pa taksa, për të ndihmuar në lëvizjen kombëtare?

Pyetja tjetër është për përfaqësuesin e ministrisë, që bëri një koment pozitiv. Në projektligj thuhet se mjetet që do të vijnë në Shqipëri nuk duhet të jenë më shumë se 20 vjet. Pra, mbi bazën e asaj që diskutoi zotëria, duhen 5-6 vjet të tjerë që ky lloj turizmi të marrë veten. I bie që nëse vijnë sot, këto mjete kalojnë në moshën 25-vjeçare. A mos janë këto të vjetra? Unë jam për të vjetrën, pasi i restauroj edhe mjetet e mia personale edhe pse janë të vjetra, por jo të gjitha mund të ishin kështu, ose mund të kalonin në shumicë, sepse kam merakun e ndotjes së detit. Ne jemi të parët e deteve, them unë.

Do të doja të kisha dy përgjigje, nëse jam kuptuar nga zotërinjtë.

Faleminderit!

**Niko Peleshi** – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Zoti Pëllumbi, fjala për ju.

**Arben Pëllumbi** – E mirëkuptoj kolegun Gjuzi, edhe në kuadër të batutave që shkëmbyem para se të fillonim mbledhjen e komisionit, edhe në raport me 5 Majin. Kështu që e kuptoj pse m'i drejtoi mua këto pyetje, por, në fakt, përgjigjen më të mirë për këtë duhet ta japë ministria. Gjithsesi, në rast se dëshiron mendimin tim, se si e mendoj unë zhvillimin e bregdetit shqiptar në raport...(Nuk dëgjohet)



Sigurisht, unë kam qenë pro dhe do të vazhdoj të jem pro ndërtimit të marinave në të gjithë bregdetin shqiptar, përfshirë edhe Portin e Shëngjinit dhe, pa diskutim, kam për të qenë gjithmonë pro që bashkëkombësit tanë të Kosovës të mund të gjejnë jo një derë të hapur në këtë port, por të gjitha dyert e hapura në të gjitha portet e Shqipërisë, sikur të jenë në shtëpinë e tyre.

Kam bërë një pyetje në lidhje me përfshirjen në këtë projektligj jo vetëm të mjeteve lundruese të tipit jahte apo edhe të mjeteve të tjera, të cilat kanë të bëjnë me aktivitete ujore argëtuese të një niveli dhe fuqie motorike më të ulët. Kam parasysht këtu motorët e ujit...

**Niko Peleshi** – Marrim përgjigjet e pyetjeve dhe më pas kalojmë në votim.

**Arben Pëllumbi** - ...apo skafet, të cilat tërheqin një parashutë, një gomone, një banane apo një gjë të tillë, pasi e dimë të gjithë që zhvillohen aktivitete të tilla në det, që ne sot na mungojnë.

Faleminderit!

**Niko Peleshi** – Faleminderit!

**Kujtim Gjuzi** – Pyetja është për zotërinë: si e parashikon çështjen e mjeteve me 20 vjet? Pra, do të na duheshin, në bazën e asaj që ju argumentuat, që në 5 vjetët e ardhshëm kjo industri të fillojë të ndërtohet, kështu e kuptova unë. I bie që 20 vjet i kemi tani, mjetet e vjetra që vijnë këtu, plus 5 të tjera, kalojnë në 25 vjet. Këto mjete, në lidhje me ndotjen e ambientit portual, a sjellin problem, apo mos duhet ulur fasha, se këto janë mjete luksi si rregull, që të jenë 15-vjeçare e sipër? Kjo ishte pyetja, zoti kryetar.

Faleminderit!

**Niko Peleshi** – Zoti Kamenica, ju lutem, fjala për ju!

**Adrian Kamenica** – Për sa i përket pyetjes së parë të zotit Pëllumbi, ne kemi futur si parashikim për përjashtimin nga TVSH-ja e jahteve të gjithë Kodin e Nomenklaturës së Kombinar të Mallrave nr. 8903, që është konkretisht “Jahtet dhe mjetet e tjera ujore që përdoren për qëllime turistike dhe argëtimi”. Pra, pak a shumë, përfshihet e gjithë gama e mjeteve ujore.

E rëndësishme për ne është që të fillojë aktiviteti i turizmit detar. Vetëm javën e shkuar ne kaluam gjithë ligjin për aktivitetet e turizmit detar, i cili mbron dhe incentivon këtë nënsektor të ri të industrisë së turizmit. Edhe me këtë përjashtim që bëjmë këtu, mendojmë se jo vetëm jahtet, po një sërë kategorish të mjeteve të tjera të përgjithshme lundruese, mund të përjashtohen nga ky projektligj, në mënyrë që të përdoren qoftë edhe për qëllime të zhvillimit të disa

aktiviteteve të turizmit, siç janë çarterat e brendshëm, të jepen me qira, të lundrohet e kështu me radhë.

Për sa i përket pyetjes së zotit Gjuzi, ne e kemi diskutuar dhe menduar shumë herë çështjen e 20-vjeçarit, sidomos me Ministrinë e Transporteve. Ka qenë një debat i vazhdueshëm, por ka disa specifika në këtë kontekst, që besoj se ju i dini më mirë se ne, sidomos për pjesën e industrisë së jahteve. Jahti nuk vjetërsohet aq shumë sa makina. Ai ka një lloj të veçantë mirëmbajtjeje. Ndaj, 20 vjet jaht është pothuajse një jaht i ri i vitit 2000, është goxha i mirëmbajtur dhe goxha i shtrenjtë.

Qëllimi ynë pse vendosëm një fashë 20-vjeçare ose një fashë të caktuar ishte sepse, për ta thënë pak më hapur, sidomos fqinji ynë Italia, ka shumë jahte të vjetra, për të cilat janë duke u përballur me një problem, se duhet t'i depërtojnë dhe nuk kanë se ku. Ne do të donim që të mos konsideroheshim një vend plehrash dhe mbetjesh të jahteve të vjetra, sepse, nëse fillojmë një incentivë të tillë, e sigurt që nuk do ta ndalonim dot këtë fluks. Ndaj vumë një fashë, një pengesë, le të themi, të vjetërsisë, e cila ka të bëjë me pjesën e motorit, ajo është pjesa më kryesore e jahtit, kurse dërrasa në përgjithësi mirëmbahet dhe nuk ka probleme as mjedisore, as gjëra të tjera. Kjo është pjesa më e rëndësishme për ne, që madje ka edhe këtë problemin e ndotjes së ambientit, ndaj dhe kemi vendosur kështu.

Nuk mendojmë dhe as besojmë se kjo fashë, edhe pas 5 vjetësh, do të jetë problem sidomos për çështjen e mjedisit, sepse jahtet 20-vjeçare janë pothuajse të reja dhe goxha të mirëmbajtura.

**Niko Peleshi** – Ka pyetje të tjera?

Zoti Pëllumbi.

**Arben Pëllumbi** – Për të vazhduar logjikën e pyetjes së zotit Gjuzi, 20 vjet do të ngelen vazhdimisht, pavarësisht faktit se kur, dikush do të blejë një jaht. Pra, edhe në qoftë se blerjen do ta bëjë në vitin 2023, po njësoj 20 duhet ta ketë që të mund të përfitoj TVSH-në zero, pra nuk mund të jetë më i vjetër se viti 2003.

Në propozimin që vjen nga ministria, do të ruhet vazhdimisht ky 20-vjeçar. Edhe në qoftë se dikush do ta bëjë pas 5 vjetësh blerjen e një mjete të tillë, duhet ta ketë jo më të vjetër se viti 2005, që të mund të përfitojë. Gjithmonë është 20 vjet, nuk shkon 22 apo 25 vjet më i vjetër, pavarësisht faktit se kur hyn në fuqi ky ligj.

**Niko Peleshi** – Po, zoti Baraj.

**Besnik Baraj** – Faleminderit!

Përshëndetje të gjithëve!

...(Nuk dëgjohej) mjedisore, pa dyshim që kërkohet të ketë një monitorim të kujdesshëm apo një laborator në qendër, që të merret me këtë problematikë. Pavarësisht se janë të reja këto mjete, ndotjet mund të vijnë edhe nga burime të tjera, nuk janë vetëm burimet motorrike, por janë edhe njerëzore...

A është parashikuar që t'i paraprijë ngritjes apo fuqizimit të një institucioni apo të një qendre që do të merret me monitorimin e ujërave detare, ku ne jemi jashtëzakonisht anemikë, nuk di çfarë fjale të përdor, pra jemi shumë të dobët në krahasim me vendet e tjera?

**Niko Peleshi** – Ka pyetje të tjera ose diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në votimin në parim të projektligjit “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Urdhëro, zoti Baraj!

**Besnik Baraj** – Bëra një pyetje dhe nuk m'u përgjigjën.

**Niko Peleshi** – Zoti Kamenica.

**Ardian Kamenica** – Pak a shumë këtë gjë e kemi diskutuar në ligjin e aktiviteteve të bëra, i cili u miratua javën e kaluar në parlament. Ajo që realizon ky ...(Nuk dëgjohej) ishte një organizim i institucioneve që kanë fusha të ndryshme përgjegjësie në lidhje me industrinë e detit. Pjesën kryesore dhe rolin në monitorimin aktivitetit të industrisë së detit e luan kapiteneria detare, por çdo institucion, sipas fushës së vetë të përgjegjësisë, do të vazhdojë monitorimin dhe do të ketë mundësi të ushtrojë fushën e vet të përgjegjësisë.

Në këndvështrimin tonë, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe i Ujërave, që është pjesë përbërëse e Ministrisë së Mjedisit, do të vazhdojë monitorimin e ujërave detare. Me zhvillimin e kësaj industrie, mendojmë ...(Nuk dëgjohej) dhe mjetet me të cilat ky Inspektoriat do të mund të ushtrojë aktivitetin edhe brenda detit, në mënyrë që të ketë mundësi, por momentalisht e kemi një fushë përgjegjësie të qartë për monitorimin e ndotjeve potenciale, nëse do të ndodhin, të ujërave detare.

**Niko Peleshi** – Dakord.

Kalojmë në votimin në parim të projektligjit. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet me një abstenim.

Zoti Gjuzi do të shpjegojë votën pro të tij.

**Kujtim Gjuzi** – Faleminderit, zoti kryetar!

**Besnik Baraj** – Kryetar, vota pro nuk shpjegohet, vota kundër shpjegohet.

**Kujtim Gjuzi** – I nderuar koleg,

Në respekt edhe të Rregullores së Kuvendit, edhe të rregullave në komision, çdo deputet ka të drejtë të shpjegojë votën, apo jo? Tani ka mbaruar procesi i votimit, apo jo? Shqiptarët më kanë akuzuar që unë dhe disa kolegë të tjerë e votojmë kundër qeverinë “Rama” në të gjitha projektligjet apo amendamentet.

**Besnik Baraj** – Merru me burra, mos u merr me llafazanë! Ata që të akuzojnë ty, janë llafazanë.

**Kujtim Gjuzi** – I nderuar koleg,

Unë do ta jap shpjegimin e votës pro në formë pyetjeje. Le të thotë sot një shqiptar, që ka mundësi të blejë një jaht, që e do votën e Kujtim Gjuzit kundër, pra nuk do të ketë, vetëm ata që janë në dijeninë e tyre me pak informacion, se nuk kam qejf t’u them që janë pak injorantë në lëvizjet financiare.

Pra ardhja këtu e jahteve është rritje e mirëqenies së disa familjeve. Dakord, por mund të ketë edhe familje të tjera, se në fillim nuk kishim mjete ne, ndërsa sot e kemi parkun me gati 800 mijë mjete, 200 mijë nga këto janë në servis dhe 600 mijë shëtisin rrugëve të Shqipërisë apo të Europës për të sjellë importe apo për të dërguar eksporte.

Ndaj, në momente të caktuara vota e deputetit konservator Kujtim Gjuzi do të jetë pro për një vendim si ky i sotmi në lidhje me këtë projektligj.

Faleminderit, zoti kryetar!

**Niko Peleshi** – Faleminderit, zoti Gjuzi!

Kalojmë në diskutimin dhe votimin nen për nen.

Neni 1. Ka diskutime? Pyetje? Jo.

Kush është dakord me nenin 1? Kundër? Zefi është kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Kush është dakord me nenin 2? Kundër? Një votë kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E votojmë në tërësi projektligjin “Për një shtesë në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar””.

Kush është dakord? Kundër? Zoti Shtjefni është kundër. Abstenim? Nuk ka.  
Miratohet.

Faleminderit për prezantimin dhe pjesëmarrjen, zoti Kamenica!



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

*Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin*

#### PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.05.2020, ora 09:00

**Drejton mbledhjen:**

**Niko Peleshi – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar””. (*Komision për dhënie mendimi*)

#### **Marrin pjesë:**

Niko Peleshi, Besnik Baraj, Robert Bitri, Eglantina Gjermeni, Tatiana Pirro, Arben Pellumbi, Kujtim Gjuzi, Nimet Musaj, Arlind Çaçani, Andrea Marto, Ardit Konomi, Ilir Ndraxhi, Ilir Beqaj, Fadil Nasufi, Halit Valteri dhe Zef Shtjefni.

#### **Mungojnë:**

Gjetan Gjetani, Rrahman Rraja, Lefter Koka dhe Klajdi Qama.

#### **Të ftuar:**

Vasilika Vjero - Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë.

Belinda Ikonomi - Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë.

Nikolla Lera - Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Adrian Kamenica - Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

Redi Baduni – Drejtor në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

**Niko Peleshi** –Vazhdojmë me diskutimin e projektligjit të dytë, që është i njëjtë me të parin, “Për një shtesë në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar””.Relator do të jetë përsëri zoti Arben Pëllumbi. Nga përfaqësuesit e ministrive që janë pjesëmarrëse, zonja Vjero dhe zonja Ikonomi, kush dëshiron të bëj prezantimin e projektligjit?

**Vasilika Vjero** – Faleminderit, zoti kryetar!

Në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për sportet, është ndërmarrë kjo nismë për të propozuar një shkallë të reduktuar në tatimin mbi vlerën e shtuar në masën 6% për ato shërbime në punime ndërtimi apo edhe për investime shtetërore, si edhe investime të klubeve, të federatave sportive, të cilat shkojnë gjithmonë në funksion të përmirësimit të infrastrukturës sportive.

Kjo ka për qëllim të sigurojë nxitjen dhe lehtësimin e investimeve pikërisht në mbështetje të sportit dhe impaktin që ka sporti në shoqëri. Pra, ajo çka ky projektligj synon është që furnizimi i shërbimeve të punimeve të ndërtimit dhe investimit po ashtu edhe nga federatat të jetë në një shkallë të reduktuar të tatimit mbi vlerën e shtuar, në masën 6%. Ndërkohë, kjo shkallë nuk do të jetë e reduktuar për blerjet në funksion të këtyre aktiviteteve, të cilat do të vijojnë të kryhen në masën 20%, siç e përcakton edhe ligji “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”.

Dua të theksoj se janë pikërisht dispozitat e nenit 49 të ligjit “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, që parashikojnë se përveç pasjes së një shkalle standarde 20% të tatimit mbi vlerën e shtuar, që aplikohet në Republikën e Shqipërisë, të mund të aplikohen edhe shkallë të reduktuara. Ajo çfarë propozohet sot është shkalla 6% e reduktuar, e cila do të çojë në lehtësimin e investimeve dhe në përmirësimin e infrastrukturës sportive për punimet e ndërtimit apo investimet që do të ndërmerren nga federata në klubet sportive kryesisht për ndërtimin e stadioneve apo të terreneve sportive, fushave të sportit, e të tjera si këto. Pra, ky është propozimi që vjen nga ministria përkatëse dhe që mbështetet edhe nga Ministria e Financave.

Për sa i përket efektit që mund të ketë kjo vlerë e reduktuar 6% në të ardhurat totale të tatimit mbi vlerën e shtuar, që është burimi kryesor i të ardhurave në buxhet, në këto momente ne nuk kemi një shifër të saktë pasi është ende herët. Fillimisht do të duhet të fillojë ky aplikim dhe do të duhet mbi një vit për të vlerësuar efektin që mund të ketë në të ardhurat buxhetore ky tatim.

**Niko Peleshi** – Faleminderit, zonja Vjero!

Fjalën e ka relatori, zoti Pëllumbi.

**Arben Pëllumbi** – Faleminderit, kryetar!

Pa diskutim, edhe ky projektligj për ne si deputetë të Komisionit të Veprimtarive Prodhuese është i mirëpritur për sa kohë ai pranohet nga Ministria e Financave dhe nga Komisioni i Ekonomisë. Ne mbështesim çdo lloj iniciative, e cila shton një aktivitet të caktuar. Ky projektligj nxit dhe synon të shtojë investimet në infrastrukturën sportive për gjallërimin sa më shumë që të jetë e mundur të aktiviteteve sportive dhe për përfshirjen sa më të gjerë të të gjitha moshave dhe kryesisht të të rinjve në aktivitetet sportive. Ky projektligj vjen në përputhje me të gjitha rregullat dhe ne e shqyrtojmë atë si komision për dhënie mendimi. Personalisht jam dakord dhe ju ftoj të gjithëve që ta votoni pro.

Përpara se ta mbyll fjalën dua të bëj një pyetje, e cila nuk ka të bëjë me Ministrinë e Financave, e cila sigurisht është për t'u përgëzuar që e pranon këtë gjë, por për ministrinë që e ka propozuar ose bashkëpropozuar, atë të Sporteve. Nga kjo ulje e TVSH-së cilat lloje të sporteve përfitojnë? E dyta, ne kemi disa liga amatore në fusha të caktuara sportive. A përfshihen edhe këto në rast se do të bëjnë investime? Pra, jashtë federatave dhe jashtë institucioneve publike, a përfshihen brenda kësaj edhe organizime amatore, të cilat mund të duan të kenë fushat e tyre? Pra, i marrim parasysh, sepse në projektligj gjej vetëm termat “investime shtetërore” ose “klube federata”?

Faleminderit!

**Niko Peleshi** – Faleminderit, zoti Pëllumbi!

Ka pyetje të tjera para se t'ia jap fjalën zonjës Vjero?

Po, zoti Gjuzi.

**Kujtim Gjuzi** - Faleminderit, kryetar!

Falenderoj zonjën Vjero dhe zotin Pëllumbi!

Dua t'ju sjell në vëmendje që konservatorët një vit më parë kanë thënë se TVSH-ja 20% është e lartë. Tani propozuesit kanë shkuar në shifrën 6%. Kjo është gjë e mirë, por gjithmonë në kalendarin kristian 2020 vjet, 1/10 - ta është, kryetar. Nëse ju dhe maxhoranca e majtë shkoni drejt shifrës 10%, pse unë nuk duhet ta votoja këtë? Unë duhet të sqaroj votën time pas goditjeve që kam marrë në shtypin e ditës dhe gati në të gjitha portalet. Pse nuk duhet ta votoja?

**Niko Peleshi** – Zoti Gjuzi, sado në rritje të jetë përqindja juaj në elektorat, mos synoni asnjëherë të keni 100% të elektoratit, sepse do të ketë edhe njerëz që merren...

**Kujtim Gjuzi** – 100% jo, se kthehet në diktaturë fashiste Partia Konservatore.



**Niko Peleshi** – Do të ketë edhe kundër, kështu që mos merrni kohën e komisionit për llogari elektorale. Ju lutem!

**Kujtim Gjuzi** – Zoti kryetar, ne këtu jemi në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese dhe jemi ndër komisionet më të rëndësishme pas atij të Ligjeve.

**Niko Peleshi** – Ju lutem, konkludoni!

**Kujtim Gjuzi** – Dakord.

Ju e keni parë që Kujtim Gjuzi pas mbërritjes së tij në parlament si konservator ka thënë që çdo gjë në parlament do të ndryshojë, edhe mentaliteti në votim do të ndryshojë. Nuk mund të themi që, meqenëse jam në opozitë, do të jem gjithmonë kundër. Kur bëhet diçka e mirë, s'ka pse të jem kundër.

Për shembull, a isha unë ai që protestova kundër Ramës për prishjen e fasadës së stadiumit? Pas protestës së fortë Rama tha: “Zoti Gjuzi, fasadën e stadiumit do ta ruajmë”. Atë e ka ruajtur. Çfarë t'i them unë atij tani, që nuk e ke ruajtur? Një gjë që është fakt, është e vërtetë. Stadiumi kuq e zi, përjashtoi kullën, i kënaq të gjithë njerëzit kur e shikojnë. Prandaj, edhe kjo pjesë imja është pjesë e votës pro.

**Niko Peleshi** – Faleminderit, zoti Gjuzi!

Ka pyetje të tjera? Jo.

Po, zonja Vjero.

**Vasilika Vjero** – Zoti kryetar, pa dashur që të kthej një përgjigje edhe për përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit, dua të them që punimet e ndërtimit dhe të gjitha investimet që do të përjashtohen janë shtetërore dhe njëkohësisht janë pjesë e asaj që quhet infrastrukturë sportive dhe rregullohet edhe nga dispozitat e ligjit “Për sportin”. E njëjta gjë vlen edhe për federatat, klubet sportive, të cilat janë të përfshira, por përgjigjen specifike për pyetjen e zotit Pëllumbi do të duhet ta japë ministria përgjegjëse e Arsimit.

**Niko Peleshi** – Ka ndonjë përfaqësues nga Ministria e Arsimit? Nuk ka.

Kush tjetër e ka kërkuar fjalën?

E keni kërkuar fjalën zoti Beqaj, sepse nuk ju shikoj mirë?

**Ilir Beqaj** – Kam probleme me lidhjen, kryetar. Nuk e di nëse më dëgjoni.

**Niko Peleshi** – Edhe ju shikojmë, edhe ju dëgjojmë. Vetëm rregulloni pak fokusin.

**Ilir Beqaj** – Unë kam pyetje konkrete. Për një objekt që është tashmë në ndërtim, fillon të pasqyrohet ky ndryshim i ligjit? Konkretisht, e kam fjalën për stadiumin e Kukësit.

Me sa kam parë unë, ka një aneks të projektligjit me një listë se cilat përfshihen në shërbimet apo mallrat që duhet të trajtohen. Si teknikë legjislativë zakonisht këto lista ne ia kemi lënë qeverisë t'i miratojë dhe këtu kam parasysh mjetet bujqësore. Unë propozoj që t'ia lëmë qeverisë këtë listë për miratim, edhe për faktin që zëvendësministrja tha që kjo është një nismë e re dhe ende nuk jemi në gjendje të bëjmë një vlerësim financiar. Ndoshta në rrugë e sipër mund të na dalë që nuk kemi qenë të saktë me këtë listë dhe pastaj do të na duhet të vijmë në Kuvend për të bërë miratimin e nevojshëm, ndërkohë që në qoftë se lista miratohet nga qeveria, edhe mundësia e ndryshimit mund të jetë më e lehtë si proces legjislativ.

Faleminderit!

**Niko Peleshi** – Po, zoti Musaj.

**Nimet Musaj** – Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë!

E nderuar zonja Vjero!

Më vjen mirë që ky projektligj ka ardhur në një moment të caktuar. Pyetja ime është e thjeshtë. Cili është impakti financiar që përfshin futbollin, sportin më popullor dhe klubet në seri të të gjitha ligave çfarë përfitimi do të kenë nëse ka ndonjë studim të veçantë?

Faleminderit!

**Niko Peleshi** – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Atëherë, zonja Vjero, ju lutem, përgjigjuni pyetjeve të mësipërme.

**Vasilika Vjero** – Patjetër!

Për sa i përket pyetjes së parë të zotit Beqaj për aplikimin e këtij ligji, sigurisht që menjëherë pasi ligji të miratohet do të fillojë edhe aplikimi. Kjo do të thotë që edhe ato punime që janë tashmë duke u kryer apo që do të ndërmerren me hyrjen në fuqi të këtij ligji, mund të aplikojnë shkallën 6%, pra, që nga momenti që ky ligj do të hyjë në fuqi, meqenëse ne kemi të bëjmë me një objekt që është në ndërtim dhe ka ende kohë që të mund të përfitohet për ato fatura apo punime, të cilat do të kryhen që nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Për sa i përket pyetjes për impaktin financiar që do të ketë, ende nuk e kemi një vlerësim të tillë, as të impaktit që do të ketë reduktimi i masës 6%, por nga ana tjetër kjo ka qenë një kërkesë shumë e fortë dhe e përsëritur e federatave, e klubeve sportive, të cilët në investimet që kryejnë në funksion të zhvillimit të sportit, gjithmonë kanë kërkuar që të kenë një shkallë të

reduktuar të tatimit mbi vlerën e shtuar, çfarë do t'u japë më shumë lehtësi dhe frymëmarrje në aktivitetin e tyre. Shërbimet e punimeve do të jenë në një shkallë të reduktuar, ndërkohë që të gjitha shërbimet, të cilat do të jenë në funksion të realizimit të këtyre punimeve do të jenë edhe me shkallën 20%. Pra, këto kompani, federata apo investime publike do të dalin më shumë me një tepricë kreditore sesa me një efekt negativ, qoftë edhe në kërkesat e tyre për rimbursimin e tatimit mbi vlerën e shtuar.

**Niko Peleshi** – Ka pyetje të tjera? Jeni të sqaruar nga përgjigjet e zëvendësministres?

Zoti Beqaj?

**Ilir Beqaj** – Çfarë mund të na thotë për çështjen e listës bashkëngjitur, që të mos jetë pjesë e ligjit, por e qeverisë?

**Niko Peleshi** – Po, edhe në analogji me mjetet bujqësore, që me shumë të drejtë e tha zoti Beqaj, ku listën e miraton Këshilli i Ministrave.

**Arben Pëllumbi** – Kryetar, ju lutem!

**Niko Peleshi** – Të dëgjojmë pak përgjigjen e zonjës Vjero dhe pastaj e keni ju fjalën.

**Arben Pëllumbi** – Edhe unë mbështes të njëjtën gjë dhe e kisha pjesë të asaj që doja të thoja, që është më mirë të mos e kemi bashkë me projektligjin. E mbështes propozimin e zotit Beqaj.

**Niko Peleshi** – Dakord.

**Vasilika Vjero** – Dakord, kryetar. Për ministrinë kjo nuk përbën asnjë shqetësim, por më tej do të duhet një akt që do të miratojë edhe listën në mbështetje të ligjit.

**Niko Peleshi** – Zoti Beqaj dhe zoti Pëllumbi, në projektligj nuk thuhet se kush e përgatit listën. Propozoni që të shtojmë një fjali?

**Ilir Beqaj** – Besoj se projektligji i referohet listës së bashkëngjitur dhe, përderisa e ka bashkëngjitur, i ngelet hartuesit kjo e drejtë.

**Niko Peleshi** – Ku e ka? Nuk e shikoj në projektligj togfjalëshin “sipas listës bashkëngjitur”. E ka, zoti Beqaj? Madje nuk e shoh as në relacion.

**Ilir Beqaj** – Atëherë, duhet të jetë një pikë në fund, ku të thuhet: “Ngarkohet Këshilli i Ministrave që për kaq muaj të nxjerrë listën”.

**Niko Peleshi** – Të shtojmë një nen tjetër?

**Ilir Beqaj** – Është lënë me udhëzim? Si është lënë? Le të pyesim zëvendësministren si e kanë menduar.

**Niko Peleshi** – Zonja Vjero, si e keni menduar? Kush e harton dhe e miraton listën e materialeve që përjashtohen?

**Vasilika Vjero** – Në fakt, ne nuk kemi përcaktuar një listë të tillë, sepse këto janë të përcaktuara në ligjin “Për sportin”. Kështu që ne duhet t’i referohemi ligjit “Për sportin”, pra terminologjia e infrastrukturës sportive dhe se çfarë përfshihet është e gjitha në ligjin “Për sportin”. Kështu që duhet të kemi të bashkëlidhur edhe një listë të tillë. Megjithatë, nëse ju gjykoni që duhet ta kemi bashkëngjitur një listë të tillë, pa diskutim që Ministria e Arsimit së bashku me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë mund ta përgatisin atë.

**Ilir Beqaj** – Zoti kryetar, mundem?

**Niko Peleshi** – Po, zoti Beqaj.

**Ilir Beqaj** – Atëherë, për sa u përket pajisjeve, unë besoj se mund të jetë dhe është më e qartë. Druhem kur vjen puna të shërbimet, sepse ndoshta sot ato janë të paparashikueshme se çfarë lloj shërbimesh mund të marrë sipërmarrja sportive dhe aktiviteti sportiv. Kështu që nuk e di si e mendon kolegu Pëllumbi, por, me siguri, ky projektligj do të shkojë të paktën edhe te Komisioni për Ekonominë dhe Financat. Nuk e di radhën e komisioneve. Pra, t’i sugjerojmë Komisionit të Ekonomisë ose komisionit përgjegjës që ta kishte në konsideratë edhe këtë mundësi. Pastaj, ata që do të bëjnë të plotin, nëse e shohin të arsyeshme, të gjejnë bashkë me ministrinë një mënyrë se si do të shprehet në projektligj. Pra, ta bëjmë relacionin tonë me rekomandimpër komisionin përgjegjës.

**Niko Peleshi** –Faleminderit, zoti Beqaj!

Zoti Pëllumbi, a keni diçka për të shtuar?

**Arben Pëllumbi** – Zoti kryetar, nuk kam ndonjë gjë për të shtuar përveç faktit që në disa projektligje, duke pasur parasysh edhe atë të mjeteve bujqësore, i është lënë qeverisë të përcaktojë nomenklaturën e mjeteve, të cilat hyjnë në fashën e ligjit që ne aprovojmë.

Është e pamundur që ne si komision apo parlamenti në përgjithësi të mund të aprovojë vazhdimisht lista, kode doganore apo kode të tjera tatimore, të cilat bëjnë përjashtim ose ligji i njeh si përjashtimore. Duam, nuk duam, përsëri i ngelet detyrimisht qeverisë kjo punë.

**Niko Peleshi** – Tani, zonja Vjero, më dëgjoni?

**Vasilika Vjero** – Po, ju dëgjoj.

**Niko Peleshi** – Më duket pak e shprehur në mënyrë të paqartë se për çfarë bëhet fjalë. Bëhet fjalë për shërbime, apo për mallra, apo edhe për mallra, edhe për shërbime? Çfarë do të thotë “aplikohet për furnizimin e shërbimeve të punimeve të ndërtimit”?

**Vasilika Vjero** – Kjo është terminologjia e ligjit. Pra, kemi të bëjmë me punime ndërtimi.

**Niko Peleshi** – Ç’do të thotë?

**Vasilika Vjero** – Të gjitha punimet e ndërtimit janë të përjashtuara, pra jo shërbime. Kjo është terminologjia që përdoret në ligjin “Për TVSH-në”. Nuk ka një listë bashkëlidhur, sepse ne kemi parashikuar që për të gjitha punimet ndërtimore të përcaktuara zbatohet kjo vlerë e reduktuar 6% e TVSH-së, pra nuk ka shërbime dhe, sigurisht, punimet e ndërtimit janë ato punime që situacionohen nga ndërtuesit.

**Niko Peleshi** – Të jenë edhe furnizimi i materialeve, edhe shërbimet.

**Vasilika Vjero** – Patjetër.

**Niko Peleshi** – Pra, kur themi “punimet e ndërtimit”, nënkuptojmë edhe materialet, edhe shërbimet e ndryshme.

**Vasilika Vjero** – Po, që janë në funksion të shërbimit. Pra, faturimi që u bëhet punimeve ndërtimore, po themi, ndërtimi i një terreni sportiv. Në rast se shteti, po themi, është investitori, kompania e cila do të kryejë në emër të shtetit një ndërtim, do t’i kryejë këto punime me vlerën e aplikuar 6%.

**Niko Peleshi** – Ju thonë që është terminologji e ligjit të TVSH-së, kjo terminologji a shoqërohet me një listë? Pra, kur themi “punime ndërtimi”, çfarë përfshihet?

**Vasilika Vjero** – Nuk ka një listë.

**Niko Peleshi** – Çfarë përfshihet në “punime ndërtimi”, se ju folët për një ndërtim të një terreni sportiv? Që të ndërtosh një terren sportiv, përveç punimeve të ndërtimit, ka edhe shërbime të tjera, si, për shembull, studimi i fizibilitetit apo projekti arkitekturor.

**Vasilika Vjero** – Jo, jo, përfshihen vetëm punimet e ndërtimit, jo studime. Pra, bëhet fjalë për ato punime, të cilat përfshihen në situacionet, të cilat dorëzohen nga kompanitë që kanë kryer ndërhyrjet, në këtë rast kanë ndërtuar një terren sportiv.

**Niko Peleshi** – Patjetër, në situacion përfshihet edhe vlera e projektit: projekti elektrik, furnizimi i materialeve të zbatimit të projektit elektrik dhe zbatimi i projektit elektrik. Pra, ka disa zëra; të gjitha janë në situacion.

**Vasilika Vjero** – Po, por furnizimi i materialeve në këtë rast përfshihet në vlerën e reduktuar. Pra, vlera e materialeve...

**Niko Peleshi** – Vetëm materialet, jo projektimi apo zbatimi, si të themi, krahu i punës?

**Vasilika Vjero** – Vetëm materialet ndërtimore.

**Ilir Beqaj** – Zoti kryetar.

**Niko Peleshi** – Nuk është e qartë, zonja Vjero.

Po, zoti Beqaj.

**Ilir Beqaj** – Atëherë, ndjesë që po bëj një hap mbrapa, por kjo që shpjegoi zëvendësministrja vjen në njëfarë mënyre si mbështetje vetëm për ato lloj sportesh, ku infrastruktura ndërtimore është goxha e rëndësishme në investimin fillestar. Por ka sporte të tjera, të cilat kanë pajisje dhe teknologji më të rëndësishme, si, për shembull, gjimnastika, peshëngritja apo, nëse duam të bëjmë një sport cilësor, ne do të duhet të investojmë shumë edhe në pjesën e laboratorëve antidoping e të tjera, kështu që krijojmë një lehtësim brenda vetë sportit. Pra, bëjmë një lehtësim në momentin e parë nga 20 e çojmë 6, por krijojmë pastaj çështje pabarazie, sepse sportet e ndryshme e kanë të ndryshme prezencën e investimit ndërtimor, pra punimet e ndërtimit, të cilave ne po ua reduktojmë fashën e TVSH-së. Megjithëse është më shumë çështje e sportit sesa e financave. Me sa shoh unë, sporti nuk është prezent në mision. Për momentin jam në konstatimin e shqetësimit, nuk jam në gjendje të bëj ndonjë propozim...

**Niko Peleshi** – Zonja Vjero, po duket shumë e paqartë, për shembull, edhe në raport me llojin e investimit apo kush e kryen investimin. Bëhet fjalë vetëm për investime shtetërore të ambienteve apo të terreneve sportive, apo edhe private? Për shembull, në qoftë se një privat ndërton një fushë futbollit, përfiton nga ky përjashtim?

**Vasilika Vjero** – Unë e përmenda si shembull, sepse ky projektligj parashikon investime të cilat do të kryhet nga institucione shtetërore, i cili do të kontraktojë një kompani private, sepse në këtë rast shteti është investitori. Nga ana tjetër, edhe ato investime që do të kryhen nga federatat dhe nga klubet e futbollit. Këto janë pak a shumë ato çfarë përfshihen në këtë shkallë të reduktuar. Pra, nëse e citoj saktë, ne kemi kërkuar që shërbimin e punimeve të ndërtimit për investimet shtetërore apo investime nga federata apo nga klubet sportive.

**Niko Peleshi** – Nga Ministria e Arsimit, e cila mbulon edhe sportin, nuk kemi pjesëmarrës? Kemi të ftuar?

Zoti Beqaj, keni diçka?

**Ilir Beqaj** – Jo, por nga shpjegimi i zëvendësministres, ajo përmendi togfjalëshin “klube futbollit”. Është vetëm për futbollin ky projektligj, apo ajo e përdori si ilustrim futbollin?

**Niko Peleshi** – Ishte për ilustrim, meqenëse unë e bëra pyetjen konkrete për një terren sportiv futbollit.

**Ilir Beqaj** – Ah, iu përgjigj pyetjes suaj, e kuptova.

**Vasilika Vjero** – Unë iu përgjigja pyetjes. Janë investime që bëjnë klubet, federatat sportive në të gjithë infrastrukturën sportive. Ishte thjesht një përgjigje dhe një shembull, mora futbollin.

**Ilir Beqaj** – Dakord, por infrastruktura sportive nuk është vetëm ndërtimi. Jua thashë, në gjimnastikë, në peshëngritje, në një palestër ku ti bën përgatitjen atletike fizike, ka shumë teknologji dhe pajisje, të cilat nuk është se vijnë me një situacion.

**Robert Bitri** – Futen te projektet e ndërtimit ato, Ilir.

**Ilir Beqaj** – Jo, nuk futen.

**Robert Bitri** – Në qoftë se nuk futen, nuk e përjashton kjo.

**Ilir Beqaj** – Këtë po them pra, por nuk është e drejtë.

**Robert Bitri** – Çfarë po diskutojmë, atëherë?! Ai është shumë i qartë aty. Pse i futemi kot tani?!

**Ilir Beqaj** – Sepse sportet e ndryshme i mbështesim në forma të ndryshme.

**Robert Bitri** – Ministria e Arsimit dhe Ministria e Financave e kanë sjellë vetëm për ndërtimin.

**Tatiana Piro** – Pajisjet e sporteve a futen te “makineri e pajisje”?

**Ilir Beqaj** – Po të mos kenë vlerën...

**Robert Bitri** – Patjetër.

**Tatiana Piro** – Me një vlerë.

**Ilir Beqaj** – Jo, jo, makineri e pajisje në prodhim. Këtu nuk është “në prodhim”, kështu që nuk futen ato atje.

**Robert Bitri** – Përsëri makineri e pajisje quhen ato.

**Tatiana Piro** – Pikërisht. Edhe këtu te pjesa e restaurimit duhen të tjera...

**Ilir Beqaj** – Makineri e pajisje ai ligji është kur ti i ke për të prodhuar.

**Tatiana Piro** – Edhe për të blerë, Ilir.

**Robert Bitri** – Pavarësisht se nuk kemi përfaqësues nga Ministria e Arsimit...

**Tatiana Piro** – Janë me fasha, Ilir: ndërtim, makineri e pajisje.

**Ilir Beqaj** – Blerje pajisjesh për çfarë?

**Tatiana Piro** – Blerje pajisje në ndihmë të sportit...

**Ilir Beqaj** – Jo pra, se ai ligji...

**Robert Bitri** – Nuk e përjashton.

**Ilir Beqaj** – Ai është për industrinë prodhuese.

**Tatiana Piro** – Jo, o Ilir.

**Ilir Beqaj** – Si jo?!

**Robert Bitri** – Tana, ashtu siç është shkruar ligji, nuk e përjashton; pikë!

**Niko Peleshi** – A keni ndonjë propozim?

**Arben Pëllumbi** – Zoti kryetar, me leje?

**Niko Peleshi** – Urdhëroni, zoti Pëllumbi!

**Arben Pëllumbi** – Në këndvështrimin tonë si Komisioni i Veprimtarive Prodhuese këtë propozim të ardhur, besoj se duhet ta përkrahim. Sigurisht, ka disa gjëra, të cilat do të donim t'i sqaronim me Ministrinë propozuese të Sporteve, siç thatë edhe ju apo siç pyeta edhe unë, nëse përfitojnë investitorë privatë, nëse përfiton liga amatore, pra që janë jashtë federatave, klubeve apo jashtë investimeve shtetërore. Kjo gjë është relativisht e paqartë këtu, por, gjithsesi, unë mendoj që ne duhet ta përkrahim... Sido që të jetë, për komisionin tonë duhet të jetë e mirëpritur.

**Kujtim Gjuzi** – Zoti kryetar.

**Niko Peleshi** – Urdhëroni, zoti Gjuzi!

**Kujtim Gjuzi** – Faleminderit, zoti kryetar.

Siç duket, edhe kolegët janë të paqartë pikërisht nga ajo që unë kërkoj përherë, çështja e protokollit. Pra, specialistët e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve nuk janë që ta konsiderojnë më mirë këtë projektligj.

Është një propozim imi: a mundet që ne ta shtyjmë këtë për një ditë tjetër për ta riparë, pasi të na bindin specialistët se si është apo se ku ndahet fasha ndërmjet “infrastrukturës” apo ndihmës së federatave të ndryshme shtetërore apo private, siç tha edhe zonja, në mënyrë që ta kemi pak më të qartë, që vota jonë të jetë më e qartë në momentin e duhur?

Faleminderit, zoti kryetar!

**Niko Peleshi** – Faleminderit!



Edhe ky propozim, zoti Gjuzi, bën sens për mendimin tim, por unë do të bëja një propozim tjetër, duke përmbledhur edhe atë që thanë zoti Beqaj, zoti Pëllumbi, edhe shqetësimin tim siç e shpreha që, meqenëse ne nuk jemi komision përgjegjës, por komision për dhënie mendimi, ta miratojmë projektligjin. Pa dyshim që nuk jemi kundër, por pro të gjitha lehtësimeve, sepse jemi Komisioni i Veprimtarive Prodhuese dhe këto lehtësime, në fund të fundit, janë lehtësime për veprimtari ekonomike, qoftë ndërtimore në këtë rast apo turistike në rastin e mëparshëm. Ta miratojmë, por në raportin tonë t'i sugjerojmë komisionit përgjegjës që të sqarojë ato dy-tri çështje për të cilat ne po diskutojmë.

Së pari, të sqarohet se cila është gama e shërbimeve ose e punimeve dhe materialeve, që përfitojnë nga ky përjashtim.

Së dyti, nëse do të përjashtohet objekti dhe çka do të thotë automatikisht e gjithë lista e situacionit apo do të ketë një listë të përcaktuar më parë të materialeve apo zërave të shërbimeve, që përfitojnë nga ky përjashtim dhe më pas, nëse do të kemi një listë, do të duhet të përcaktohet se kush e harton dhe miraton listën. Këto dy-tri çështje më mirë të mos i shterojmë ne, të mos u japim ne zgjidhje, por t'ia sugjerojmë në raport komisionit përgjegjës dhe ne ta miratojmë ligjin siç është, por me këto vërejtje, në raport.

Si mendoni? A jeni dakord të procedojmë kështu?

Dakord.

E hedhim në votim në parim projektligjin.

Kush është dakord, në parim me projektligjin “Për një shtesë në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”?”

Dakord në parim.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te miratimi i neneve, nen për nen.

Kush është dakord me nenin 1, siç është, por e thamë vërejtjet tona do të përfshihen në raport?

**Kujtim Gjuzi** – Zoti Kryetar.

**Niko Peleshi** – Urdhëro, zoti Gjuzi.

**Kujtim Gjuzi** – Unë në parim e votoj ligjin, kurse te pjesa që është për ta shtyrë ligjin, filloj e abstenoj. Pra, është abstenim një votë.

**Niko Peleshi** – Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim?

Abstenim, zoti Gjuzi. Një votë abstenim.

Miratohet.

Neni 2.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim?

Abstenim, zoti Gjuzi.

Miratohet.

E hedhin në votim, në tërësi. Kush është dakord në tërësi? Kundër? Nuk ka. Abstenim?

Abstenim, zoti Gjuzi.

Miratohet.

Faleminderit edhe përfaqësuesve të ministrisë!

Ndërkohë, besoj se dy zëvendësministret, zonja Ikonomi dhe zonja Vjero, do të qëndrojnë edhe për pikën e tretë, që është projektligji "Për përmirësimin e zonave të biznesit (BID)".



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 05.05.2020, ora 09:00

**Drejton mbledhjen:**

**Niko Peleshi – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Projektligji "Për përmirësimin e zonave të biznesit (BID)". (*Komision për dhënie mendimi*)

**Marrin pjesë:**

Niko Peleshi, Besnik Baraj, Robert Bitri, Eglantina Gjermeni, Tatiana Pirro, Arben Pellumbi, Kujtim Gjuzi, Nimet Musaj, Arlind Çaçani, Andrea Marto, Ardit Konomi, Ilir Ndraxhi, Ilir Beqaj, Fadil Nasufi, Halit Valteri dhe Zef Shtjefni.

**Mungojnë:**

Gjetan Gjetani, Rrahman Rraja, Lefter Koka dhe Klajdi Qama.

**Të ftuar:**

Belinda Ikonomi – Zëvendësministre e Ministre e Financave

Vasilika Vjero – Zëvendësministre e Ministre e Financave

Arvid Uruci - Përfaqësues i Drejtorisë Juridike në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Ridvan Troashani - Përfaqësues i Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim

Ekflodia Leskaj - Përfaqësuese e Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim

Ardjana Sheti - Juriste te Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim

**Niko Peleshi** - Kalojmë te projektligji "Për përmirësimin e zonave të biznesit (BID)". Ky është një projektligj i ri, i cili ka lidhje me një koncept të ri dhe praktikisht e ka filluar implementimin në Shqipëri, janë zonat për nxitje, për zhvillimin e biznesit. Akronimi është në anglisht *BID Business Improvement District*.

Unë dua të falënderoj dhe t'i uroj mirëseardhjen online përfaqësuesve të Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, të cilët janë edhe nxitësit, frymëzuesit kryesorë, jo vetëm të projektligjit, por para projektligjit, të ndërtimit të zonave BID, kryesisht, rreth zonave këmbësore në disa qytete të vendit tonë, si në Shkodër, në Korçë, në Berat, në Tiranë, diku rreth zonave me trashëgimi kulturore dhe historike. Ngaqë ka dhe një konkurrencë të fortë turizmi, janë quajtur TID, pra *Tourism Improvement District*, po që janë në të njëjtin koncept dhe besoj se do ta shtjellojmë edhe më tej.

Besoj se ky është ligji nga i cili përfitojnë edhe organizatat BID, edhe organizatat TID, sepse në kuptimin e ligjit, pra janë organizata BID. Dua t'i falënderoj, siç e thashë, përfaqësuesit e fondacionit sepse kanë bërë një punë të jashtëzakonshme, si dhe janë bërë pionierë të këtij koncepti të ri zhvillimor lokal. Unë kam pasur rastin të bashkëpunoj që nga momenti i konceptimit të këtyre zonave dhe deri në implementim dhe pastaj ndërtimin e organizatës dhe mbarëvajtjen e tyre dhe me të vërtetë ka qenë një eksperiencë e jashtëzakonshme.

Këto investime kanë shumëfishuar vetveten, pra investimet fillestare për ndërtimin e zonave këmbësore apo zonave rreth të cilave është ngritur organizata BID, janë shumëfishuar për shkak të rritjes së vlerës së pasurive të patundshme, për shkak të eventeve të shumta të zhvilluar në to, në mënyrë të pazakontë për Shqipërinë, duhet thënë, nga vetë bizneset, të cilat shpeshherë janë përballur me frikën nga ndryshimi, nga transformimi, por më pas janë bërë mbështetësit kryesorë të këtyre zonave këmbësore. Kemi disa të tilla në Shqipëri, siç e përmenda, kemi në Vlorë, në Berat, në Gjirokastrë, në Korçë, në Shkodër, në Krujë, në Tiranë, nuk e di nëse kam harruar ndonjë.

Gjithsesi, më duhet ta bëja këtë falënderim, siç e thashë, e ndiej dhe kam qenë shumë pranë këtyre projekteve në vite. Pa humbur kohë, të fillojmë me prezantimin e projektligjit "Për përmirësimin e zonave të biznesit (BID)". Relator është zoti Dritan Bici, i cili ka një eksperiencë në punën me pushtetin lokal, ndaj mendova që ai të jetë relatori në këtë projektligj. Të ftuar nga

ministritë kemi përsëri zonjën Belinda Ikonomi, zëvendësministre Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, si dhe përfaqësuesit e Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim.

Ia jap fjalën zonjës Ikonomi, për prezantimin, nëse jeni dakord dhe më pas relatori Dritan Bici dhe të tjerët.

Zonja Ikonomi.

**Belinda Ikonomi** – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Siç ju e përmendët, vërtet ky është një ligj mjaft i rëndësishëm dhe një koncept novator që prezantohet përpara jush ditën e sotme. Gjej rastin të falënderoj Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, i cili ka kontribuar me sjelljen e ekspertëve për hartimin e këtij ligji. Pra, në vetvete projektligji sjell një risi dhe një koncept novator për zonat, për përmirësimin e biznesit, të cilat, në fakt, kanë fituar terren dhe po përdoren në vendet perëndimore për zhvillimin e qyteteve, duke përcaktuar zona të veçanta, ku bizneset vetorganizohen, me synimin për një menaxhim sa më cilësor të zonës, për shërbimet publike shtesë, për krijimin e kushteve më atraktive për qytetarët dhe për konsumatorët.

Aktualisht, BID-et në konceptin e këtij ligji, janë bashkësi kontraktore të bizneseve, pra të gjitha bizneset kanë një rol të barabartë, pavarësisht qarkullimit që ato kanë, të cilat bashkohen dhe rregullohen nga një prospekt, që është një dokument bazë, i cili tregon vizionin strategjik për zhvillimin e zonës, i cili më pas miratohet sipas procedurave për zhvillimin e zonës nga autoriteti lokal. BID-i në vetvete propozohet dhe është i gjerë, propozohet nga vetë anëtarët, pra nga vetë bizneset në zonën ku ato ushtrojnë aktivitetin, propozohet nga një organizatë jofitimprurëse që ka funksione, pra të njëjta si një organizatë BID, si dhe nga një dhomë tregtie, pra këtu i japim një rol edhe dhomave të tregtisë, sikundërse edhe nga bashkia përkatëse, bazuar mbi planet strategjike që ajo ka për zhvillimin e qytetit.

Procedurat janë shumë të qarta në ligj, se si bëhet propozimi, se si bëhet procesi i miratimit, pra në çdo rast do të kemi një miratim përkatës nga bashkia, nga pushtetit vendor, në mënyrë që projekti të jetë në linjë edhe me prioritetet për zhvillimin ekonomik të qytetit. Pa dyshim, një element shumë i rëndësishëm është që duhet të ketë dakordësinë e shumicës së sipërmarrësve që ekzistojnë në zonë, për të vazhduar më tutje në miratimin e BID-it dhe pastaj në ngritjen e një organizate, e cila më pas do të bëjë të mundur dhe funksionimin e të gjithë procedurave, për të operuar më tej për zhvillimin e zonës. Siç edhe ju e përmendët, me shumë të

drejtë, efekti ekonomik i këtyre organizimeve BID është një praktikë e njohur në Shqipëri, pra ka funksionuar, kemi pasur raste në mjaft qytete, ku treguesit kanë qenë shumë pozitivë dhe është vënë re një ndërgjegjësime dhe një pjesëmarrje shumë aktive e bizneseve, e cila është shoqëruar edhe me tregues shumë pozitivë për sa i përket rritjes së numrit të konsumatorëve, rritjes së punësimit, rritjes së qarkullimit të këtyre bizneseve.

Ajo që është vënë re gjatë kësaj periudhe, është se mungon një bazë ligjore, pra mungon një rregull i shkruar, dhe pikërisht me këtë projektligj ne synojmë të normojmë dhe të rregullojmë statusin ligjor, qëllimin, afatin, procedurat, marrëdhëniet ligjore ndërmjet pushtetit vendor dhe organizatave BID, në mënyrë që të kemi një kuadër ligjor rregullator, për funksionimin dhe dhënien e hapësirave bizneseve për ta shfrytëzuar këtë lloj mundësie. Pra, sikundërse u përmend edhe këtu, modeli BID është një model tërësisht lokal dhe ndihmon drejtpërdrejt për riorganizimin e iniciativave, iniciativa që prekin komunitetin, për përballimin më të mirë të shërbimeve shtesë që janë në funksion gjithmonë të zonës. Në fakt, projektligji ka kaluar një proces të gjatë konsultimi, janë marrë në konsideratë dhe janë bërë, në mos gaboj, nga të dhënat që po shikoja, rreth 85 rekomandime, nga të cilat janë pranuar 75 prej tyre, pra janë në marrë në konsideratë të gjitha rekomandimet e kryera nga dy shoqatat përfaqësuese të bashkive dhe pa dyshim janë marrë në konsideratë edhe propozimet nga bashkitë, të cilat kanë pasur deri tani bashkëpunim dhe kanë krijuar zona BID, si bizneset që ju përmendët, bizneset e prekura dhe bizneset përfituese nga ky projekt.

Një element që dua ta referoj, në ditën e sotme, është që aktualisht janë dy bashki që kanë parashikuar në projektplanet e tyre strategjike për zhvillim, krijimin e BID-ve. Kështu, u referohem Bashkisë Tiranë, e cila ka parashikuar në strategjinë e zhvillimit të qëndrueshëm, 2018-2022 krijimin e dy BID-ave të reja, një në Kombinat dhe një në Kinostudio, ndërsa Bashkia Shkodër, ka parashikuar në buxhetin e saj krijimin e një zone të re BID. Pra, miratimi i këtij projektligji, pa dyshim do të ndihmojë vënien në zbatim të këtyre planeve të bashkive dhe mendoj që është një element mjaft i rëndësishëm për t'u adresuar.

Pak a shumë, shkurtimisht, se këtu kemi edhe përfaqësuesit e Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, do t'ju ftoja për të diskutuar për çdo pyetje të mundshme, për këtë projektligj.

Faleminderit!

**Niko Peleshi** – Shumë faleminderit, zonja Ikonimi!

Zoti Kujtim, para se ta merrni fjalën, fjalën e ka zoti Bici, si relator.

**Dritan Bici** – Faleminderit, kryetar!

Në radhë të parë, dua t'ju falënderoj për urimet që më dhatë, me rastin e ditëlindjes dhe dua t'ju them që të keni të mira dhe gëzime edhe ju, në familjet tuaja!

Për sa i përket projektligjit, dua të them që është një projektligj, që ka si qëllim t'i hapë rrugën rigjallërimit të zonave të biznesit në qytete dhe në qyteza urbane, duke lehtësuar zhvillimin e tyre, rritjen ekonomike dhe zhvillimin e qëndrueshëm në zonat BID përkatëse, ku ka përqendrim të lartë të biznesit të vogël. Ashtu siç tha edhe zonja Ikonomi, ky është një ligj i ri, pra është një risi në trajtimin që i bëhet biznesit, si dhe në krijimin e kushteve lehtësuese për biznesin.

Nëpërmjet neneve ligji shprehet qartë që nga krijimi i BID-it, nëpërmjet propozuesve të BID-it, marrjen e informacionit nga bashkitë përkatëse, propozimin për BID, autorizimin e propozimeve për BID, prospektin e BID-it, procedurat e njoftimit për BID, miratimin, regjistrimin, aktet dhe dokumentet e tjera personale të organizimit, burimet e financimit, kuotat, përjashtimet e veçanta të zbatueshme për organizatën, të drejtat dhe detyrimet e organizatës dhe pagesve të kuotës, të drejtat dhe detyrimet e bashkisë, palët e interesit, përfundimi dhe shpërndarjen e zonës BID.

Pra, ligji është i plotë, është i qartë, shpjegon hap pas hapi, nga fillimi, mënyrën e krijimit të kësaj zone, të zonave të përmirësuara të biznesit dhe jep një ndihmëse të madhe në krijimin e shërbimeve shtesë që do të kryhen në zona të caktuara. Megjithatë, ngelen edhe disa probleme që ne duhet t'i diskutojmë këtu, qoftë me njëri-tjetrin, qoftë edhe me propozuesit, për të krijuar një ide më të qartë lidhur me disa probleme që dalin.

Fillimisht, do të ushtrohen vendimmarrjet e autoriteteve lokale. Duhet të sqarohet, nëse, kur bëhet fjalë që propozues i BID-it do të jetë bashkia, në këtë rast, kush do ta marrë vendimin? Vendimin duhet ta marrë këshilli bashkiak apo duhet ta marrë kryetari? Kjo është pyetja e parë që shtrohet ose që ndoshta është e paqartë.

Së dyti, gjatë procesit të votimit propozimi për BID mund të parashikohet në një procedurë ankimi, ku t'i krijohen mundësi komunitetit të zonës apo edhe vetë bashkisë të ankohet për rastet e parregullsive të konstatuara në votim. Duke qenë se zona BID krijohet menjëherë, me një shumicë të thjeshtë, pra, mbi 50% të votave, mendoj që duhet të jetë më i strukturuar procesi sesi do të bëhet votimi. Për sa i përket shumicës së thjeshtë të votimit, do të

konsiderohet biznesi një njësi apo do të merren në konsideratë edhe elemente të tjera, si sipërfaqja, xhiroja, përfitimi i parashikuar nga BID apo kuota e detyrueshme nuk do të jetë e njëjtë për të gjithë, pra do të konsiderohen edhe elementë të tjerë?

E treta, “e drejta dhe detyrimi i pronarit apo i poseduesit” këtu mbetet e paqartë nëse do të jetë pronari i objektit apo poseduesi i objektit që do të ketë të drejtën e votimit, por, njëkohësisht, edhe detyrimin për pagimin e kuotës. Pra, a do të jetë pronari i objektit, apo poseduesi të mbledhja e kuotës? Projektligji parashikon që kuotën mund ta mbledhë bashkia dhe agjentët e saj tatimorë, madje duket sikur kështu do të funksionojë. Pse duhet ta bëjë bashkia këtë gjë, kur organizata BID ka strukturat e saj, të cilat, ashtu siç do të menaxhojnë këtë kuotë, mund të sigurojnë edhe mbledhjen e kuotës?

Për sa u përket përjashtimeve, projektligji parashikon mundësinë e lirimit nga detyrimi për pagesën e kuotës në spitalet shtetërore, komunitetet fetare, shkollat dhe njësitë e qeverisjes vendore. Kjo parashikohet në ligj, ndërkohë që disa përjashtime të tjera do të parashikohen në prospekt, pra do të bëhen të gjitha në prospekt, në qoftë se këto institucione janë anëtare. Këto institucione, të cilat do të jenë anëtare të organizatës, kanë të drejtë apo nuk kanë të drejtë vote? Pse duhet të votojnë për propozimin për BID nëse do të jenë bashkëfinancuese?

Problemi tjetër që mbetet për t’u diskutuar dhe për t’u sqaruar ka të bëjë me parashikimet që lidhen me legjislacionin tatimor. Projektligji parashikon që kuota BID do të konsiderohet shpenzim i zbritshëm për efektet e tatimfitimit, gjithashtu, parashikon që organizata BID përfiton lehtësi tatimore, sipas legjislacionit tatimor. Këto parashikime nuk mund të bëhen në ligje të veçanta, pasi janë pjesë e përjashtimeve të bëra në legjislacionin në fuqi tatimor.

Tjetër problem: në kreun III të projektligjit nuk parashikohet se cila do të jetë struktura e organizatës BID; si do të zgjidhen anëtarët; si do të funksionojnë kjo organizatë në rast se do të ketë anëtarësi; si do të funksionojë kjo organizatë nëse nuk do të ketë anëtarë dhe çfarë detyrimesh do të ushtrojë kjo organizatë?

Vazhdimësia e shoqatave ekzistuese

Projektligji parashikon te disa dispozita kalimtare që shoqatat e krijuara më parë do të vazhdojnë të funksionojnë si të tilla edhe për një vit. Kështu që brenda kësaj periudhe duhet të bëjnë propozimin për BID. Ata që nuk e bëjnë nuk do të konsiderohen si organizatë BID në përputhje me këtë ligj.



E para, si do të detyrohen që të mos jenë më përfaqësues të një zone BID ekzistuese dhe kush do të jetë propozuesi për BID në këtë rast? A do të mbetet kjo zonë ekzistuese BID? A do të vazhdojë funksionimin, siç vazhdonte deri para hyrjes në fuqi të këtij ligji?

E dyta, lidhur me afatin, nëse një zonë ekzistuese ka një afat të caktuar organizata e re që do të krijohet, sipas parashikimeve të këtij ligji, a do të ketë një afat të ri, apo do të vazhdojë të funksionojë në afatin e mbetur nga BID-i ekzistues?

Projektligji parashikon që një BID shtrihet brenda kufijve të territorit të autoriteteve lokale, pra brenda kufijve të një autoriteti lokal. Ndoshta do të lindë nevoja që të përdoret një koncept për zhvillimin e zonave që janë në kufijtë territorialë të dy apo më shumë autoriteteve lokale. A mund të krijohet një hapësirë ligjore edhe për këtë rast?

Pra, pak a shumë këto janë problemet që mbeten për t'u sqaruar. Megjithatë, unë, si relator, e shikoj shumë të mirë këtë ligj, i cili i vjen shumë në ndihmë ekonomisë së bizneseve, njëkohësisht edhe rritjes së nivelit të shërbimeve. Prandaj, u bëj thirrje të gjithë anëtarëve të komisionit ta miratojnë këtë ligj.

Faleminderit!

**Niko Peleshi** – Faleminderit, zoti Bici, për prezantimin, por edhe për pyetjet e shumta, për të cilat i takon zonjës Ikonimi të përgjigjet, por pasi të mbledhim edhe disa pyetje të tjera!

Zoti Gjuzi, të lutem, më lejo t'ia jap fjalën zotit Nasufi, ndonëse e keni ngritur dorën të dy njëkohësisht, sepse zoti Nasufi ka një eksperiencë vetjake shumë të suksesshme në ndërtimin (në bashkëpunim me qeverinë dhe me *Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim*) e një zone këmbësore dhe një organizate BID në qytetin turistik të Beratit. Është një eksperiencë shumë e vyer për ta ndarë me ne të tjerët, kështu që po ia kaloj fjalën zotit Nasufi.

Më pas fjalën e ka zoti Gjuzi dhe më pas zonja Gjermani, e cila, gjithashtu, ka një eksperiencë me një organizatë BID në Krujë, por jo vetëm, edhe ai një projekt shumë i suksesshëm.

Po, zoti Nasufi!

**Fadil Nasufi** – Faleminderit, kryetar!

Unë po marr pjesë si anëtar zëvendësues në këtë komision thjesht për të ndarë një eksperiencë nga implementimi i projektit BID në Berat në vitin 2013 të financuar nga *Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim*, si një nga eksperiencat më mbresëlënëse dhe më produktive të karrierës sime si kryetar bashkie.

Më vjen mirë që ligji për zonat e përmirësimit të biznesit apo dhe për zonat e zhvillimit të turizmit vjen pas një modeli shumë shembullor që është bërë në Korçë, në Shkodër, në Krujë, në Tiranë, në Berat, në Gjirokastrë, tashmë edhe në Vlorë.

Unë dua të falënderoj veçanërisht *Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim* për këtë ofertë që solli në Shqipëri për zhvillimin e këtyre projekteve nga më të spikaturat dhe më gjurmëlënëset që ka realizuar për zonat BID, një nga modelet që edhe “Rilindja” urbane u mbështet për këtë lloj përvoje që nisi në këto projekte që u realizuan. Për mendimin tim, edhe ligji i ofruar që në fazën e hartimit, në fazën e konsultimit, në fazën e ekspertizës dhe relacioni i paraqitur është shumë profesional. Unë nuk mendoj se do të ketë nevojë për shumë ndërhyrje nga anëtarët e komisionit për ta votuar, pavarësisht pyetjeve që ngriti ose sqarimeve që kërkoi relatori Dritan Bici. Kështu që, lidhur edhe me modelin e teknikës legjislativë, përsëri asistenca e *Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim* është për t’u përshëndetur.

Po ju tregoj rastin e Beratit. Ngritja në nivel ligji e kësaj marrëdhënieje të partneritetit me BID, të cilën e kemi pasur në një organizmin vullnetar ose në një formë marrëveshjeje, rrit përmirësimin e zonave të biznesit dhe kjo është një gjë shumë pozitive.

Bulevardi qendror i qytetit të Beratit ishte vend parkimi për automjete, me gjitha ato biznese kaotike të çorganizuara, me një funksionim tradicional alla shqiptarçe, pa asnjë lloj vizioni, pa asnjë lloj larmie, por me një konkurrencë absurde, ku më shumë vrisnin mendjen se si do të parkoheshin makinat para kafenesë, se sa si të bënin xhiro për rehati të gjithë njerëzit që frekuentonin qendrën e qytetit. Kështu, pati shumë skepticizëm, pati edhe tendenca për ta bllokuar investimin e *Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim*, por më në fund u realizua. Ne kemi pasur pritshmëri shumë të larta, por disa sqarime dhe disa përfitime konkrete, rast pas rasti, janë pasqyruar edhe me modele në relacionin që na është paraqitur në këtë projektligj.

Unë mendoj se nga ky investim u përfitua jo vetëm ndërhyrja në infrastrukturën e bulevardit të qytetit, në sheshin qendror “Teodor Muzaka”, në fasadat e qytetit, në çështjet që kanë të bëjnë me arredimin e bizneseve, në përmirësimin e profilit të bizneseve, në larminë e aktiviteteve të bizneseve, por edhe në kualifikimin e organizatës BID, në trajnimin e stafëve, në përmirësimin e shërbimeve të 78 subjekteve që ka pedonalja e Beratit, si dhe në shumë atraksione të tjera që solli si risi projekti BID.

Sot, pas 6 vjetësh, unë mund të them se zona BID është një nga zonat më atraktive të qytetit të Beratit, që i bashkëngjitet zonës muzeale, e cila është një nga zonat me frekuentimin

më të lartë nga qytetarët dhe turistët, ku gati është pesëfishuar vlera e pronës dhe ka një larmi të madhe të aktiviteteve të biznesëve. Gjithashtu, është përmirësuar shumë ana estetike, ana e arredimit, janë futur elemente të gjelbërimit, zhvillohen shumë aktivitete që kanë të bëjnë me evente kulturore dhe artistike, ku zhvillohen rreth 40 aktivitete në vit. Ju besoj se e mbani mend që në qendër të Beratit ka qenë hoteli i famshëm, Turizmi i Beratit, i cili mbeti pothuajse jashtë zonës së BID-it. U mendua që të bëhej një projekt i ri i hotelit, për arsye se u futën në konkurrencë të gjitha bizneset e kësaj zone shumë atraktive dhe shumë potenciale në pikëpamjen e zhvillimit. Kështu që unë mendoj se këto modele do të mbështeten fuqimisht në të gjithë Shqipërinë, atje ku ka vullnet të biznesëve, ku ka vetorganizim të biznesëve, sepse sot ato e kanë modelin dhe kanë shembullin më të mirë se si mund të kenë projekte zhvillimi kaq të qëndrueshme dhe kaq të suksesshme.

Unë dua të them se jo gjithmonë partneriteti ka qenë i suksesshëm. Bashkia në shumë raste, sidomos në mandatin që u mbyll 2015-2019, nuk ka qenë shumë partnere me organizatën BID dhe me *Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim*, përkundrazi, ka qenë frenuese në iniciativat e biznesit. Prandaj, edhe në ligj, ashtu siç janë parashikuar nënë të posaçme të partneritetit bashki me biznesin, duhet të zbatohen detyrimet kontraktore, pra detyrimet e partneritetit ndërmjet pushtetit vendor dhe biznesit, sepse biznesi është ai që gjeneron të ardhura, është ai që i jep frymëmarrje gjithë zhvillimit të qytetit. Prandaj, unë e mbështes plotësisht këtë projektligj dhe mendoj se do të japë impakt të menjëhershëm jo vetëm në bashkitë, që kanë filluar të zgjerojnë zonën e biznesit, siç është Tirana, por modele të tilla do të ketë në të gjitha qytetet e tjera. Duke qenë se edhe trashëgimia e biznesit shqiptar është pak kaotike, unë mendoj se në këtë lloj vetorganizimi dhe me këto lloj modelesh ato do ta gjejnë veten më mirë të organizuara dhe më mirë të progresuara.

Faleminderit!

**Niko Peleshi** – Shumë faleminderit, zoti Nasufi!

Zoti Gjuzi, keni fjalën.

**Kujtim Gjuzi** – Faleminderit, zoti kryetar!

E përshëndes nismën e *Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim* në lidhje me këtë gjë dhe ndryshim, por nuk mund të jem dakord me kolegët parafolës kur thonë se biznesi shqiptar është, në njëfarë mënyre, në zhvillime kaotike. Kjo nuk është e vërtetë. Pas humbjes së tregut të lirë në vitet '44– '90 si pasojë e diktaturës, ne kemi 30 vjet që bëjmë biznes; dhe unë,

sikurse edhe ju, zoti kryetar, jemi ndër sipërmarrësit e parë në Shqipëri që kemi rrisur, që kemi sjellë këtu të ardhura, që kemi bërë investime në Shqipëri. Në këtë rast absolutisht jam shumë dakord që të kemi një projektligj të tillë, por nuk mund të bie dakord me disa gjëra që i tha edhe zoti Bici në relatin e tij, pra që bizneset, të cilat nuk i binden kësaj logjike, duhet që pas një viti të shkojnë drejt asaj, që mund të konsiderohet si mbyllje e fondacionit.

Fondacionet i mbyll vetëm gjykata shqiptare, sepse ajo ua ka dhënë licencimin dhe vetëm ajo ka të drejtën t'i tërheqë ato. Pra, nuk mund të ushtrojmë trysni ose presion, se këtu pastaj mund të bien në ato që quhen afera, që mund të suportohet një lëvizje apo një lëvizje tjetër.

Lidhur me ato çka thanë kolegët, unë besoj se jua thashë në formën e këshillimit. Normalisht ju e dini shumë mirë që unë jam i pasionuar pas lëvizjeve euroatlantike, normalisht edhe nga trashëgimia familjare. Kështu që dal përsëri aty: si mundet unë ta kundërshtoj këtë ligj?! Pra, nuk mund ta kundërshtoj. Prandaj, po e them edhe për një objeksion më të gjerë të njerëzve: kur shikoni që konservatorët japin votën pro, ata janë të bindur se duhet dhënë vota pro; kur abstenojnë, përsëri e bëjnë se kanë dyshime në lidhje me projektligjin, kurse kur janë kundër është një gjë që ata nuk mund ta suportojnë dot, prandaj edhe votojnë kundër.

Faleminderit, zoti kryetar!

**Niko Peleshi** – Faleminderit!

Po ia kaloj fjalën zonjës Gjermani, e cila ka një eksperiencë, gjithashtu, shumë të vyer të paktën në ngritjen e disa zonave BID dhe TID në Shqipëri kur ishte në pozicionin e ministres së Zhvillimit Urban.

Zonja Gjermani, fjala për ju.

**Robert Bitri** – Kam edhe unë një pyetje.

**Fadil Nasufi** – Ju kërkoj ndjesë, por më duhet të largohem, pasi më duhet të jem në orë 11:00 te Varrezat e Dëshmorëve.

Faleminderit!

**Niko Peleshi** – Faleminderit, zoti Nasufi, për prezantimin e eksperiencës së Beratit!

Fajlën e ka zonja Gjermani.

**Eglantina Gjermani** – Faleminderit, zoti kryetar!

Ashtu siç e thatë edhe ju, përvoja 4-vjeçare si ish-ministre e Zhvillimit Urban më ka dhënë mundësinë dhe privilegjin të punoj me Fondacionin Shqiptaro – Amerikan dhe të jem partnere në organizimin e disa zonave për përmirësimin e biznesit. Edhe ju si

zëvendëskryeministër keni qenë shumë pranë në këtë proces dhe them që kemi kontribuar modestisht që këto zona të zhvillohen.

Gjej rastin të falenderoj Fondacionin Shqiptaro – Amerikan për gjithë kontributin dhe partneritetin e jashtëzakonshëm që ka dhënë ndër vite, duke krijuar modele të sukseshme, të cilat janë aplikuar në bashki të ndryshme!

Tani po flas si deputete e Krujës dhe shpreh mirënjohjen e të gjithë qytetarëve për angazhimin dhe kontributin konkret për Pazarin e Vjetër të Krujës dhe për përmirësimin e biznesit dhe zhvillimin e turizmit në këtë zonë.

Projektligjin e konsideroj shumë të rëndësishëm dhe të vlefshëm dhe them që, sidomos në periudhën që po kalojmë, ai merr një rëndësi të veçantë, duke nxitur dhe ndihmuar biznesin, punësimin, zhvillimin e turizmit në këto zona, duke krijuar mundësi më të mira ekonomike për qytetarët në këto zona, madje për t'i zhvilluar ato në zona të tjera.

Kolegët parafolës, ju, kryetar, kolegu Nasufi, pa dyshim, zoti Lici dhe zëvendësministrja Ikonomi e theksuat rëndësinë dhe angazhimin e qeverisë shqiptare për ta bashkëhartuar dhe sidomos vullnetin politik për ta implementuar këtë projektligj. Unë mendoj se ky projektligj është në kohën e duhur, është i duhuri për t'u implementuar dhe do të ketë një impakt shumë pozitiv në zhvillimin e biznesit në këto zona dhe në zona të tjera.

Unë kam dy çështje për të cilat do të doja sqarime.

E para, për organizatat BID, të cilat parashikohen në kreun III të këtij projektligji, besoj se e tha edhe zoti Bici si relator, nuk jam shumë e qartë lidhur me strukturat e tyre, kur kanë ose kur nuk kanë anëtarësi. Mbase vërtet sipas juristëve mund të konsiderohet e tepërt për t'u vendosur në projektligj dhe mund të jetë në aktet nënligjore, por unë dua të jem e qartë, sepse mendoj se disa elemente ose disa parime bazë duhet të jenë në ligj, që të zhvillohen më tej në aktet nënligjore.

Një merak tjerër që kam edhe nga përvoja, por edhe nga ajo që tha zoti Nasufi, është bashkëpunimi dhe ndërvarësia me pushtetin vendor. Duke qenë se në pushtetin vendor janë kryetari, këshilli bashkiak dhe strukturat e pushtetit vendor, të cilat shpeshherë kanë qenë shumë bashkëpunuese dhe të angazhuara, në disa raste, siç u përmend, nuk kanë qenë dhe aq bashkëpunuese. Prandaj dua që organizatat BID të kenë një lloj proaktiviteti dhe të mos u pengohet puna herë pas here nga pushteti vendor, qoftë nga kryetari apo nga këshilli bashkiak, për interes të të gjithë komunitetit. Nuk e di sa qartë janë rregulluar këto në ligj, duke mos qenë

vetë juriste, por dua që të kenë një lloj pavarësie relative ndaj pushtetit vendor dhe të mund të fokusojnë duke qenë në partneritet, por jo t'u pengohet puna. Këtë shqetësim kam, që mund të ma shpjegojnë. Nëse është e mirëpërcaktuar në ligj, atëherë jam dakord.

Kam një pyetje në fund. Duke qenë se është miratuar edhe ligji i zejtarisë, i cili besoj se është një ligj i rëndësishëm, sepse ndihmon zonat ku punojnë artizanë, si është marrëdhënia me këtë projektligj? A kanë ndonjë pikë të përbashkët? A e plotësojnë njëri-tjetrin apo mund të ndihmojnë më shumë artizanët në zhvillimin e artizanatit në Shqipëri dhe për vazhdimin e kësaj trashëgimie të pasur që ka Shqipëria?

Faleminderit!

**Niko Peleshi** – Faleminderit, zonja Gjermani!

Kush e do fjalën për pyetje? Po, zoti Beqaj.

**Ilir Beqaj** – Faleminderit!

Së pari, zoti kryetar, ju ftoj të mos shfrytëzoni pozicionin për të risjellë në vëmendje punët që keni bërë në detyra të ndryshme, sepse na vini në siklet ne të tjerëve. Ne e dimë se çfarë është bërë në Krujë, në Korçë e në Berat dhe i shijojmë, por unë nuk mund të jem cinik dhe t'ju them: ejani të shikoni sa të mira janë bërë sallat e operacioneve! Prandaj të mos bëjmë konkurrencë mes atyre ku kemi punuar dikur.

Së dyti, unë mendoj se ne nuk paskemi nevojë për projektligj, sepse edhe nga ajo çfarë ju parashtruat, kemi funksionuar shumë mirë edhe pa ligj dhe, përgjithësisht, kur gjërat shkojnë mirë pa ligj nuk kemi përse të bëjmë ligj! Tashmë ka një eksperiencë 7-8-vjeçare që nga rastet e para të krijimit, me mbështetjen e fondacionit, edhe si ide, edhe si model biznesi, edhe si bazë ligjore, edhe si legjislacion.

Për mendimin tim, në gjithë këto vite modelet e krijuara janë pak a shumë të ngjashme: qendrat historike të qyteteve tona me elemente të trashëgimisë kulturore, të rivitalizuara dhe të sjella në hapësira urbane shumë atraktive dhe shplodhëse, që i kanë dhënë vlerë zhvillimit të zonave ku janë bërë.

Unë nuk e falënderoj dot fondacionin për një arsye shumë të thjeshtë: para tre vjetësh i kam propozuar fondacionit të shfrytëzonte të njëjtën ide, por në një mënyrë pak më ndryshe. Një hapësirë, në vlerësimin tim personal, ku fondacioni mund të vinte dorë janë llixhat e Peshkopisë. Ajo nuk është një zonë me vlera historike, por ka elemente të përbashkëta, çlodhëse, mjekësore dhe kurative. Nëse fondacioni do ta kishte marrë për bazë propozimin, para 2-3 vjetësh, vitin

tjetër, kur mbaron Rruga e Arbrit, dikush mund të nisej nga Tirana brenda ditës, të shkonte në llixhat e Peshkopisë dhe të kthehej, pra të kthehej në një lëvizje ditore, sepse pjesa kurative është elementi më i veçantë i asaj çfarë ofrojnë bizneset e vogla.

Në fund të fundit, me çfarë kam parë në Krujë, në Berat dhe në Korçë, tipologjia e bizneseve është biznese shërbimesh, që quhen “*low touch economy*”, siç janë baret, kafetë, restorantet, dyqanet që shesin prodhime artistike dhe zejtarët që bëjnë gjëra tradicionale, ndërsa me llixhat e Peshkopisë do të kishim një model krejt tjetër.

Nuk dua të zgjatem, por kam vetëm një merak të fundit. Në projekt thuhet që do të hyjë në fuqi për një vit, por kam përshtypjen se kjo ide ka qenë para pandemisë COVID-19. Këto zona, për arsye të detyrimit për distancim fizik, do ta vuajnë pak më gjatë këtë punë. Ndoshta në këtë periudhë të parë atyre që duhet ta rimendojnë nëse duhet të jenë pjesë apo jo e zonave mbas një viti, do të duhet t’u lini pak më shumë kohë.

Faleminderit!

**Niko Peleshi** – Zoti Beqaj, faleminderit për këshillën, të cilën duhet të ta kthej mbrapsht, për hir të së vërtetës, sepse nuk e quaj të pavend që kolegët të sjellin eksperiencat e tyre nga punët e kaluara, pra nuk ka asnjë gjë të keqe. Përkundrazi, secili vjen këtu me një histori nga mbrapa, e kam fjalën për historitë profesionale, dhe kush ka qenë ministër, kryetar bashkie apo drejtues i një institucioni dhe ka një eksperiencë, që mund t’i vlejë komisionit, unë do ta ftoj gjithmonë që ta ndajë me të tjerët.

Për sa më përket, edhe unë mund të sjell eksperiencën time, por jo duke thënë se sa mirë e kam bërë unë, por se çfarë kam mësuar. Besoj se deri tani nuk e kam thënë ndonjëherë se sa mirë e kam bërë këtë punë kur kam qenë aty apo këtu.

Zoti Beqaj, neve nuk na lidh puna me fushën e shëndetësisë, por nëse do të kemi ndonjë pikëprerje do t’ju ftoj ta ndani punën tuaj me ne dhe ta thoni në mënyrë të drejtpërdrejtë, jo siç e thatë tani, si ajo historia që "nuk dua t’ju them që bardhoshja ka ditëlindjen", pra "nuk dua t’ju them se sa të mira janë bërë sallat e operacioneve". Kjo ishte për shaka.

Tani fjalën e ka zoti Bitri. Më pas fjalën e ka zoti Musaj.

**Robert Bitri** – Faleminderit, zoti kryetar!

E uroj relatorin për ditëlindjen, u bëftë edhe 100 vjet! Pra, kishte dy urime, si relator i çështjes dhe për ditëlindjen. Gëzuar!

Unë kam një pyetje, që mundet të më kthejë përgjigje zonja Ikonomi.

Themi që BID-in mund ta krijojë edhe një individ, a është e vërtetë? Kur themi që mund ta krijojë me ose pa anëtarë, në Shqipëri kemi shumë individë, sepse ne i japim përparësi atij që propozon i pari krijimin BID në një zonë, në një pjesë të bashkisë apo në një rrugicë, pra nëse individë të veçantë, të cilët nuk mund të krijojnë autoritetin dhe personalitetin për ta krijuar këtë BID, kur mund të jenë edhe disa njerëz të tjerë më vonë, pasi i vjen një propozim nga dikush...

Nuk e di, a jam në linjë?

**Niko Peleshi** – Po, zoti Bitri, vazhdoni.

**Robret Bitri** – Në këtë moment ky individ krijon BID-in dhe i propozon bashkisë. Më mbropa mund të ketë edhe një grup tjetër, që është pjesë e asaj zone mund të ketë një propozim tjetër, por ne i japim përparësi atij që ka bërë propozimin e parë. Mos duhet parë kjo gjë dhe të saktësohet? Pra, përparësi nuk mund të ketë afati me të cilin vjen propozimi, por ai që është më i suksesshëm, më thelbësor ose më zhvillues për rrugicën ose për pjesën turistike. Unë dua këtë përgjigje nga ju. Ju i thatë të gjitha, por nuk e thatë që BID-in mund ta krijojnë edhe individë të veçantë. Kjo është pyetja ime.

**Niko Peleshi** – Faleminderit, zoti Bitri!

Fjalën e ka zoti Musaj.

**Nimet Musaj** – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë dua të bëj dy-tri pyetje të shkurtra, duke parë dhe duke vlerësuar punën që ka bërë fondacioni. Si ka qenë bashkëpunimi me bashkitë e qarkut Fier, ku janë 6 bashki? A ka pasur kërkesa nga këto bashki dhe propozime nga dhomat e tregtisë? Si e shikoni në përgjithësi këtë qark?

Faleminderit!

**Niko Peleshi** – Faleminderit edhe juve!

A ka pyetje të tjera?

Fjalën ia jap zonjës Ikonomi për përgjigjet e pyetjeve. E dimë që janë shumë pyetje, por nëse është e mundur mund t'i përmblihdhni.

**Belinda Ikonomi** – Po, patjetër. Në fakt kemi edhe përfaqësuesit e fondacionit, por unë po i referohem disa pyetjeve që mbajta shënim.

Për sa i përket pjesës së votës, pra detyrimi i pronarit apo i poseduesit, projektligji e ka shumë të qartë se kush ka të drejtë vote dhe këtë e ka poseduesi. Poseduesi në vetvete nënkupton çdo pronar, qiramarrës, posedues të tjerë të një njësie tregtare në zonën BID. Pra, gjithmonë



është në formën e një subjekti tregtar, qoftë person fizik apo juridik. Personat që kanë të drejtë vote, mund të jenë ata persona fizikë ose juridikë që, përpos faktit që kanë biznes, kanë edhe pronësinë e objektit.

Për sa i përket pyetjes tjetër për mbledhjen e kuotës, pra faktit se përse duhet të ishte bashkia apo agjentët e saj, gjithashtu, referoj që në bazë të projektligjit kjo është e hapur, pra mbledhjen e kuotave mund ta bëjë vetë organizata BID dhe sipas marrëveshjes operationale me bashkinë mund të kërkojë ndihmën e bashkisë apo agjentëve të saj për mbledhjen e kuotës. Pra, janë lënë të hapura të gjitha opsionet, në mënyrë që ligji të mos krijojë kufizime, por ta lërë të hapur këtë çështje dhe le të themi për një lloj marrëdhënieje direkte me bashkinë përkatëse.

Për sa u përket parashikimeve për punën e përjashtimeve, sikundër u përmend këtu, si çdo ligj tjetër pak a shumë, për shembull ligji “Për taksat vendore”, janë parashikuar për t’i përjashtuar nga kuotat institucionet publike, shkollat dhe organizatat fetare. Pra, këto janë përjashtime nga taksat që janë në çdo ligj. Gjithashtu, lihet e hapur që kur bëhet prospekti, vetë biznesi mund të vendosë të bëjë përjashtime të caktuara dhe kjo është gjithmonë në marrëdhënien, që do të realizohet dhe miratohet nga vetë anëtarët e komunitetit të biznesit.

Për sa i përket pjesës së parashikuar në legjislacionin tatimor, që lidhet me përjashtimet fiskale, po, është e vërtetë që pagesa e kuotës është parashikuar që të jetë shpenzim i zbritshëm dhe referimi këtu bëhet në atë mënyrë që të mos këtë paqartësi. Gjithashtu për sa i përket konceptit, organizata BID i referohet gjithmonë ligjit “Për organizatat jofitimprurëse”, që të ketë të njëjtin trajtim sikurse organizatat e tjera jofitimprurëse, të paktën referimi që ka ardhur nga ana ligjore, siç është pjesa e regjistrimit, e tatimit mbi fitimin dhe të gjitha gjërat e tjera me radhë, të gëzojë të njëjtat të drejta dhe detyrime, duke qenë me qëllim jofitimprurës.

Për sa u përket *fee-ve* territoriale, pra pjesës së bashkëpunimit ndërmjet minibashkive, projektligji nuk e parashikon këtë gjë, por pa dyshim që ligji “Për pushtetin vendor” i parashikon ndërveprimet e bashkive, që janë në kufi me njëra-tjetrën, kështu që pa dyshim që do të ketë ndërthurje të legjislacionit për pushtetin vendor me këtë legjislacion dhe në momentin kur kemi dy rajone që preken me njëra-tjetrën, fare mirë mund të integrohen me njëra-tjetrën bazuar mbi një marrëveshje përkatëse.

Për sa i përket pjesës së vendimmarrjes së bashkive, projektligji është hartuar me shumë kujdes nga ekspertët që të jemi gjithmonë në përputhje me legjislacionin përkatës të pushtetit vendor, pra për të mos cenuar parimet e tij. Vendimmarrja e bashkisë do të jetë sipas

legjislacionit përkatës dhe është në kompetencën e kryetarit, ose në kompetencën e këshillit bashkiak sipas referimit përkatës ligjor në ligjin “Për qeverisjen vendore”.

Në lidhje me pjesën e ankimimit ligji parashikon që propozuesi, dhe në këtë rast mund t’u përgjigjemi edhe pyetjeve të zotit Bitri, pra kush e bën, një individ, duhet të jenë minimumi 5 posedues të njësive tregtare që kanë të drejtë të bëjnë propozimin. Gjithmonë ky propozim, pasi merren të dhënat përkatëse nga bashkia, se cilat janë zonat ku të gjitha bizneset ushtrojnë aktivitet, i shkon bashkisë për të parë nëse është në përputhje me strategjitë, me kushtet dhe kriteret që ka bashkia, se është njësia vendore që ka kompetencën në territor edhe për sa i përket zhvillimit ekonomik. Në rastin e një vendimmarrjeje negative nga bashkia, askush nuk i heq të drejtën çdo qytetari të ankimojë në bazë të Kodit të Procedurave Administrative vendimmarrjen e bashkisë dhe të kërkojnë më tepër sqarime me këtë pjesë.

Në lidhje me ndërthurjen mes ligjit të zejtarisë dhe këtij ligji, në fakt, ligji i zejtarisë lidhet më tepër me pjesën e profesioneve, pra me zhvillimin e zejtarisë dhe organizimin e këtij profesioni dhe nuk ka lidhje direkte, por patjetër që në komunitete të caktuara, kur e gjitha zona përbëhet nga zejtarët, ekziston e drejta për t’u parashikuar si zonë BID dhe kemi ndërveprim direkt ndërmjet këtyre.

Për sa i përket pyetjes së fundit se si ka qenë bashkëpunimi me Bashkinë e qarkut Fier, do të kërkoja nga përfaqësuesit e fondacionit të bënin komentet përkatëse se ata kanë qenë direkt në bashkëpunim me këtë bashki. Nëse kam harruar ndonjë pyetje, ju kërkoj ndjesë, por ndoshta përfaqësuesit e fondacionit mund të bëjnë një sqarim shtesë të këtyre që bëra unë.

Faleminderit!

**Niko Peleshi** – Faleminderit, zonja Ikonomi!

Ftoj përfaqësuesit e Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim që të plotësojnë përgjigjet e zonjës Ikonomi, në rast se ka ngelur diçka pa përgjigje, ose nëse keni diçka specifike për të shtuar.

Do t’ju lutesha, meqë jemi në limitet e kohës, të mos bëni mbivendosje me prezantimin e deritanishëm të projektligjit, apo me gjëra që janë thënë, vetëm nëse keni diçka për të shtuar!

**Ridvan Troshani** – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë jam Ridvan Troshani, projektmenaxher pranë AADF-së bashkë me mua është kolegja juriste Eflodia Leskaj dhe përfaqësuesja e studios ligjore Ardiana Shehi.

Ju falënderoj të gjithëve për angazhimin dhe për të gjithë mirënjohjen e shprehur për punën e përbashkët.

Më lejoni të etiketoj një fakt shumë të rëndësishëm: për çdo dollar të investuar në zonat BID nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan kemi një përgjigje mjaft pozitive të qeverisë shqiptare dhe të pushtetit lokal me tjetër investim, që do të thotë se drejt ekonomisë lokale është injektuar një sasi e konsiderueshme vlere monetare, asistencë teknike dhe burime njerëzore, në mënyrë që të jetë e suksesshme si model. Tani jemi në fazën e dhënies së një instrumenti të duhur, të nevojshëm dhe të domosdoshëm të të gjithë iniciativave të tjera ligjore, të bizneseve për t'u përfshirë në menaxhimin e interesave të tyre të përbashkëta në zonë, ku ato zhvillojnë biznesin. Duke dashur t'i jap një përgjigje zotit Musaj për bashkëpunimin me Bashkinë e Fierit, do të ishte ndoshta e pamundur një përgjigje për të gjitha kërkesat e bashkive, por aprovimi i këtij ligji hap rrugën që zona të caktuara dhe interesa të caktuara të zonave gjeografike, apo zonave me destinacion turistik, apo biznesi në qytete të ndryshme, apo në qendra urbane, ose edhe në qendra të tjera me interes për biznesin, të mund të marrim iniciativa dhe të mund të zhvillojnë si model atë që parashikon ligji. Kështu që është një mundësi shumë e madhe sesa zbatimimi aktual i modelit.

Duke pasur në konsideratë raportin mes bizneseve dhe bashkisë, më lejoni të theksoj se në fazën e parë të propozuar nga 5 biznese, nga bashkia, nga një organizatë jofitimprurëse në zonë, apo nga Dhoma e Tregtisë, si dhe me aprovimin e bashkisë, fillon një pavarësi relative e vetë modelit, që do të thotë se nëpërmjet marrëveshjes subvencionale me aprovimin e dokumentacionit për aprovimin e modelit BID, tanimë janë bizneset që bashkëpunojnë dhe menaxhojnë fondet me interes të përbashkët. Kështu që kemi arritur një lloj pavarësie të iniciativës së vetë biznesit nëpërmjet propozimit të këtij projektligji.

Në raport me pyetjen e shtrimit të organizatave ekzistuese, në ligj parashikohet për afërsisht një vit për t'u dhënë kohë 8 organizatave, që janë të listuara në Shqipëri si organizata BID mbi bazën e ligjit "Për organizatat jofitimprurëse", të kenë mundësi të shndërrohen sipas procedurave që parashikohen në këtë ligj. Besoj se është një kohë e mjaftueshme, duke i dhënë kohë të gjithë procesit të parashikuar në aktet nënligjore, që do të dalin në vijim pas miratimit të ligjit.

Faleminderit!

**Ardjana Sheti** – Në lidhje me pyetjet që u shtruan në komision, dua të bëj një falënderim, pasi ishin të gjitha me vend. Zonja Ikonomi ishte mjaft shteruese në dhënien e përgjigjeve, megjithatë, nëse do të më lejoni, unë do të doja të bëja një shpjegim për efektet e leximit të ligjit dhe kjo do t'u jepte përgjigje qoftë pyetjeve, që u bënë për organizatat BID, qoftë për pyetjen që bëri zoti Beqaj se pse duhej një ligj i veçantë. Për të lexuar ligjin është e rëndësishme të kuptojmë që kemi një bashkësi kontraktore të poseduesit të njësive tregtare dhe organizatën BID. Të dyja bashkë duhen marrë si pjesë e këtij modeli inovator që shpjegoi zonja Ikonomi. Pra, BID-i është bashkësia kontraktore. Nëse unë do të bëj analogji me fondin e institucionit privat, ose fondet e investimeve për ata që janë të orientuar në këtë pikë, është pikërisht kjo bashkësi kontraktore. Organizata BID do të bëjë administrimin e fondit të kësaj bashkësie kontraktore. Pra, për të pasur një organizatë ku do të këtë një personalitet juridik për të kontraktuar, për të blerë shërbime, për të menaxhuar fondin e bashkësisë kontraktore, ne kemi nevojën e organizatës BID.

Pikërisht ky dallim është i rëndësishëm që ta mbahet parasysh gjatë leximit të ligjit, pasi ky model tërësor, pra bashkësia kontraktore bashkë me organizatën BID, kanë krijuar nevojën e bërjes së një ligji të veçantë, sepse vërtet AADF-ja u mundua të gjente zgjidhjen ligjore për fillimin e projekteve në përputhje me legjislacionin ekzistues, por ishte një zgjidhje e përkohshme. Duke qenë se ne kemi përdorur mbi të gjitha legjislacionin për organizatat fitimprurëse, ajo ka sjellë edhe ngërçe sidomos me hyrjen dhe daljen e anëtarëve në organizatën BID, sepse duhet të zbatohen procedurat përkatëse për të shkuar në gjykatë për efekt të tërheqjes së një anëtari, por ligji krijon fleksibilitet më të madh në kuptimin e organizimit dhe funksionimit të të gjithë skemës, pra të bashkësisë kontraktore dhe të organizatës BID, që, siç thashë ka funksionin për të administruar fondin BID.

Për sa i përket pyetjes suaj për organizatën me anëtarësive dhe pa anëtarësi, duhet të kemi parasysh se organizata BID shërben për administrimin e fondit BID. Pra, mund të krijohet një organizatë e re.

**Niko Peleshi** – Më falni, sepse ky është një koncept i ri, me të cilin nuk jemi mësuar. Ju thatë se në këtë ligj koncepti BID ka dy anë: njëra është bashkësia kontraktore dhe tjetra është organizata BID, e cila menaxhon fondit e krijuar nga kuotat e bashkësisë kontraktore. Kjo është ideja, apo jo?

**Ardjana Sheti** – Po.

**Niko Peleshi** – Pra, edhe pasi është regjistruar organizata BID, këto dy koncepte qëndrojnë?

**Ardjana Sheti** – Qëndrojnë.

**Niko Peleshi** – Domethënë, edhe pasi është regjistruar organizata BID ne mund të flasim me bashkësinë kontraktore dhe organizatën BID?

**Ardjana Sheti** – E para, duhet të kemi parasysh se kemi bashkësinë kontraktore dhe organizatën BID, që qëndrojnë në mënyrë simultane dhe njëkohësisht. Anëtarësia në BID-in kontraktor nuk do të thotë se çdo anëtar në BID-in kontraktor është edhe anëtar i organizatës. Në ligj ne kemi dhënë të drejtën që çdo anëtar i BID-it kontraktor mund të jetë edhe anëtar i organizatës BID, por kjo është në zgjedhjen e personit, për arsye se organizata BID nuk merret absolutisht me pjesën e rregullimit të të drejtave apo detyrave të anëtarëve të BID-it kontraktor, por merret vetëm me administrimin e BID-it.

**Niko Peleshi** – Më falni, kuotën e paguajnë të gjithë anëtarët e bashkësisë kontraktore dhe e menaxhon një organizatë, e cila mund të ketë edhe më pak anëtarë?

**Ardjana Sheti** – Patjetër.

**Niko Peleshi** - Pra, mund të jenë 100 anëtarë të bashkësisë kontraktore dhe 10 anëtarë të organizatës BID?

**Ardjana Sheti** – Po.

**Niko Peleshi** - Kemi, si të thuash, një kontratë menaxhimi, BID-in.

**Ardjana Sheti** – Prandaj unë bëra analogji me fondin e pensioneve private dhe fondet e investimeve, domethënë që ekzistojnë si bashkësi kontraktore, por, në fund të fundit, administrimin e bëjnë shoqëritë e administrimit të fondit të pensioneve ose të fondit të investimeve. Është pothuajse e njëjta logjikë. Në këtë rast ne kemi BID-in kontraktor, siç thatë ju, që mund të ketë 100 anëtarë, por kemi edhe organizatën BID, e cila mund të jetë me anëtarësi ose pa anëtarësi.

Nëse është me anëtarësi dhe nëse të gjithë anëtarët e BID-it kontraktor do të duhet të jenë anëtarë, patjetër që mund të jenë, por kjo organizatë BID mund të jetë edhe pa anëtarësi, në formën e një fondacioni ose të një qendre shërbimi, dhe në këtë rast në organin vendimmarrës do të jenë ata persona që caktohen nga BID-i për të qenë përfaqësues të BID-it kontraktor në organizatën BID.

Mendoj se ky dallim është shumë i rëndësishëm për t'u pasur parasysh gjatë leximit të ligjit. Besoj se kjo u jep përgjigje disa pyetjeve që shtruat ju, mbi të gjitha, për arsyen pse ishte i nevojshëm një ligj i veçantë, sepse nëpërmjet këtij ligji ne normojmë një model të ri ligjor të organizimit të BID-ve në zona të ndryshme.

**Niko Peleshi** – Cili është statusi juridik i bashkësisë kontraktore?

**Ardjana Sheti** – Nëse do të kalojmë në terma më ligjore, ne kemi një koncept në Kodin Civil, që quhet “shoqëria e thjeshtë”. Edhe legjislacione të tjera e përdorin që 2 ose më shumë persona mund të bëhen bashkë në një shoqëri të thjeshtë dhe mund të bëjnë aktivitetet. Kjo ka qenë bazueshmëria në bazë të Kodit Civil, pavarësisht se këtu përdoret edhe një parim kushtetues i të drejtës së organizimit. Në këtë kuptim BID-i kontraktor bëhet bashkë në bazë të Kushtetutës dhe Kushtetuta e këtij BID-i kontraktor është prospekti. Në prospekt parashikohen të gjitha të drjetat dhe detyrimet e anëtarëve në BID-in kontraktor. Edhe njëherë po bëj analogji me fondin privat të pensioneve dhe me fondin e investimeve. Anëtarëve të fondit të pensionit dhe të fondit të investimeve u jepet pikërisht prospekti. Prospekti është Kushtetuta që i bën bashkë dhe aty parashikohet edhe objekti i BID-it, dhe kështu do të jetë edhe në prospektin e BID-it, edhe të drejtat dhe detyrimet e anëtarëve në BID. Gjithmonë BID-i kontraktor në këtë rast nuk do të ketë të drejtë patjetër që të legjitimojë mbledhjen e kuotës, por administrimin e fondit do ta bëjë organizata BID, siç e shpjegova. Ky është i vetmi funksion i organizatës BID. Organizata BID ka në thelb si zbatueshmëri, ligjin për organizatat jofitimprurëse dhe do të menaxhojë jo vetëm fondin BID, i cili është tërësia e kuotave të paguara nga anëtarët e BID-it kontraktor, por ka të drejtë të marrë edhe financime të tjera, qoftë nga bashkia, qoftë edhe nga donatorë privatë të huaj apo vendas. Pikërisht maksimizimi i mbledhjes së fondit BID në organizatën BID bën të mundur që duke krijuar një xhep më të madh, do të blihen më shumë shërbime për zonën BID. Pra, nëse në dispozicion deri tani janë shërbimet bazë publike, si: pastrimi, disa elemente gjelbërimi e të tjera, duke pasur një xhep më të madh BID-i patjetër do të ketë mundësi të blejë shumë shërbime të tjera, ndriçim më të mirë, rrugë më të mira, pastrim jo vetëm fshirje, por edhe larje të zonës ku janë përqëndruar bizneset, siç shikojmë edhe në vendet e tjera.

**Niko Peleshi** – Mbaruat?

**Ardjana Sheti** – Për sa u përket elementeve të tjera ligjore, zonja Ikonomi u tregua shteruese për zëjtarinë. Nëse ne shikojmë përkufizimin e zëjtarit, për t'ju përgjigjur pyetjes, në ligj zëjtari është person publik ose fizik. Duke qenë se bashkësia kontraktore përbëhet pikërisht

nga personat juridikë dhe fizikë, posedues të njësive tregtare, rregullimi është i njëjtë. Edhe nëse ne do të kemi një përqendrim të zëjtarëve në një zonë të caktuar, pa diskutim që ata mund të hyjnë në BID, kështu që konsiderohen, thjesht për efekt të leximit të ligjit, si persona juridikë, edhe fizikë, të cilët, nëse posedojnë një njësi tregtare në zonë, kanë të drejtë të jenë anëtarë të BID-it kontraktor.

**Niko Peleshi** – Një pyetje ishte se pse është i nevojshëm ligji, ndërkohë që gjërat kanë shkuar mirë edhe pa ligj?

**Ardjana Sheti** - Unë u përpoqa të jap shpjegim.

I gjithë modeli ka pasur nevojë për një ligj të veçantë. Ajo që është bërë deri tani ka gjetur zgjidhje në legjislacionin ekzistues, i cili është ligji për organizatat jofitimprurëve. Të gjitha BID-et deri tani janë ofruar si shoqata dhe funksionimi i tyre nuk ka akomoduar të gjithë këtë model, sepse modeli parë është pikërisht ajo që shpjegova; BID-et kontraktore dhe organizata BID funksionojnë të dyja bashkë dhe përbëjnë të gjithë modelin. Ndërkohë që deri tani është gjetur zgjidhje nëpërmjet ligjit për organizatat jofitimprurëse. Të gjithë këta anëtarë janë organizuar në shoqatë dhe kjo nuk ka krijuar fleksibilitet, sepse ju e dini sa lëvizje ka në zonat e përqendrimeve të bizneseve në qendrat e qyteteve, ku biznese të caktuara mund të vendosin të zhvendosen ose mund të mbyllin aktivitetin e tyre. Kjo krijon një nga vështirësitë që duhet të pasqyrojë gjithmonë anëtarësia me regjistrimet në gjykatë. Kjo nuk krijon fleksibilitet për efekt të funksionimit të BID-it, ndërkohë që BID-i kontraktor është më fleksibël, që të drejtat dhe detyrimet e atij që do të zëvendësojë anëtarin e BID-it, që largohet nga zona dhe zëvendësohet me një të ri, në BID-in kontraktor, ai pranon të drejtat dhe detyrimet e bashkësisë kontraktore, më pas të prospektit nëse në zonën ku ai do të vendosë të shkojë, është e krijuar tashmë një BID.

**Ekflodia Leskaj**– Do të doja të shtoja edhe diçka, që nëse deri tani janë krijuar BID-e nëpërmjet marrëveshjes të mirëkuptimeve midis ADF-së dhe bashkive, duke pasur një ligj të posaçëm për këtë fushë, me mundësinë e krijimit të BID-eve të reja, pavarësisht ndikimeve të ADF-së apo prezencës së ABSH-së për të inkurajuar krijimin e këtyre BID-eve, sepse ligji jep procesin përfundimtar se si krijohet një BID. Për më tepër u siguron qëndrueshmëri BID-eve nëpërmjet marrëveshjes operationale që parashikohet në ligj, që lidhet mes organizatës BID me bashkinë përkatëse. Pra, këto janë avantazhet që ofron kuadri i posaçëm ligjor.

**Niko Peleshi** – Faleminderit për të gjitha sqarimet!

Nuk e di nëse ka ngelur ndonjë pyetje pa përgjigje, dhe në rast se ka, mund ta thoni, ose të kalojmë në votim, sepse pyetje mund të dalin edhe gjatë diskutimit nen për nen, ku mund t'i sqarojmë edhe më konkretisht.

Kalojmë në votimin në parim.

Kush është dakord në parim me projektligjin "Për përmirësimin e zonave të biznesit (BID)"? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Zoti Çarçani abstenon.

Miratohet.

Kalojmë në miratimin nen për nen.

Neni 1 "Objekti dhe qëllimi i ligjit".

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet.

Neni 2 "Përkufizimet".

Këtu kam një pyetje për pikën 14, ku bëhet fjalë për "poseduesin". Pse të mos themi "pronari i biznesit"?

**Robert Bitri** – Sepse ai mund ta ketë marrë edhe me qira.

**Niko Peleshi** – Të thuhet "pronar i biznesit", jo "pronar i godinës".

Pra, del e paqartë se çfarë do të thotë "posedues".

Mund të jetë edhe pronari i godinës pa biznes, mund të jetë edhe pronari i biznesit pa godinën në pronësi, apo jo?

**Ilir Beqaj** – Posedimi duhet të jetë opsion që në Kodin Civil.

**Dritan Bici** – Ai që zotëron për momentin, kryetar.

**Niko Peleshi** – Në Kodin Civil do të jetë pronar, apo jo?

**Ardjana Sheti** – Po.

**Niko Peleshi** – Në Kodin Civil do të thotë pronar. Bëhet fjala për pronarin e pasurisë së patundshme të objektit apo edhe pronari i biznesit të një objekti të marrë me qira quhet posedues, sipas këtij ligji? Kam frikë se do të bjerë në kundërshtim me Kodin Civil.

**Dritan Bici** – Ai që e zotëron në momentin e krijimit të zonës, zoti kryetar!

**Niko Peleshi** – Sipas Kodit Civil, ai nuk quhet posedues, por quhet disponues. Në qoftë se e kam gabim, të më korrigjojnë juristët.

**Dritan Bici** – Sipas Kodit Civil, quhet posedues, pra ai që e zotëron për momentin.

**Niko Peleshi** – Jo, ai quhet disponues.



**Dritan Bici** – Hapeni dhe shikojeni. Sipas Kodit Civil, quhet posedues.

**Niko Peleshi** – Në rregull, por më mirë ta dëgjojmë nga juristët.

A ka një përgjigje nga fondacioni?

**Ardjana Sheti**– Po.

Për efekt të konceptit, së pari, ne duhet të konsiderojmë logjikën që të bëhen bashkë biznese, të cilat janë të përqendruara në një zonë të caktuar. Pikërisht mbi këtë bazë krijojmë konceptin e poseduesve të njësive të tregtare, pra njësitë tregtare janë pasuri e paluajtshme, të cilat ndodhen në një zonë të caktuar ku ka përqendrim biznesi. Sigurisht, BID-i ka synim të bëjë bashkë bizneset që ushtrojnë aktivitetin, pavarësisht nëse janë pronarë të këtyre njësive tregtare, janë qiramarrës apo kanë të drejta të tjera posedimi. Në bazë të Kodit Civil, është termi “posedues” për atë që, në fund të fundit, përdor pronën për një kohë të caktuar, ndërsa e drejta e disponimit është diçka tjetër, është drejta e transferimit të pronës e të tjera. Kështu që jemi të saktë dhe korrektë me konceptin e Kodit Civil, prandaj dhe i kemi konsideruar si posedues.

Shumica e bizneseve, të paktën bizneset e vogla në këto përqendrim janë qiramarrës, nuk janë pronarë të njësive tregtare. Prandaj edhe ne jemi tregtuar të kujdesshëm që të jemi shumë shterues në përkufizimin që kemi përdorur.

**Niko Peleshi** – Edhe një herë, sepse nuk dëgjohehi shumë mirë. Në një zonë BID, edhe pronari i objektit në zonën BID, ku zhvillohet aktiviteti tregtar, edhe pronari i aktivitetit tregtar të dy konsiderohen posedues dhe anëtarë të bashkësisë BID?

**Ardjana Sheti** – Në qoftë se ka një pronë në zonën BID, ajo ose nuk përdoret për qëllime tregtare dhe nuk është dhënë me qira, atëherë në këtë rast posedimin e ka pronari, mundësia tjetër është që ajo të jetë e dhënë me qira te njësitë tregtare. Në qoftë se pronari zhvillon vetë biznes në godinën që e ka pronë, atëherë do të jetë personi fizik, pra tregtari, i cili do të jetë anëtar i BID-it kontraktor.

**Niko Peleshi** – Po flas për skenarin tjetër. Për shembull, jam pronari i një objekti dhe e kam dhënë me qira te Ridvani, i cili ushtron aktivitet tregtar. A mund të konsiderohet posedues anëtar i bashkësisë?

**Ardjana Sheti**– Ridvani, sepse është ai që e posedon ligjërisht në këtë moment. Kështu që Ridvani që bën biznes në zonë BID, do të jetë anëtar i BID-it kontraktor.

**Niko Peleshi** – Nuk quhet posedues i objektit Ridvani, sipas Kodit Civil quhet disponues, me sa di unë, poseduesi është pronar.

**Ardjana Sheti** – Në qoftë se ka një kontratë qiraje, Ridvani është posedues.

**Niko Peleshi** – Në rregull, Komisioni i Ligjeve do ta kalojë këtë, apo jo?

Më tepër është çështje e Komisionit të Ligjeve, por, meqenëse ai nuk është përfshirë në diskutimin e këtij projektligji, ndaj po hapemi edhe në tema që janë ligjorë. Gjithsesi, po e verifikojmë nëse termi juridik “posedues” në Kodin Civil nënkupton edhe poseduesin e aktivitetit në një objekt, të cilin nuk e ke në pronësi. Mund të jetë. Nuk e ka në të gjitha rastet poseduesi.

**Ardjana Sheti** – Po flasim për poseduesin e njësisë tregtare, pra të pronës së paligjshme, e cila ndodhet në zonën BID, që të mos ngatërrohem.

**Niko Peleshi** – Domethënë, disponuesi është pronar, jo poseduesi, pra është e kundërta. Atëherë, keni të drejtë. Posedues mund të jesh edhe pa qenë pronar i objektit.

Atëherë, a ka ndonjë vërejtje tjetër për nenin 2 “Përkufizimet”? Kush është dakord me nenin 2? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet neni 2.

Neni 3 “Qëllimi i BID-it”. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet.

Neni 4 “Afati i BID-it dhe ripërtëritja”. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet.

Neni 5 “Propozuesi i BID-it”. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet.

Neni 6 “Marrja e informacioneve nga bashkia përkatëse, me qëllim zhvillimin e propozimit për BID-in”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet me një abstenim.

Neni 7 “Propozimi për BID-in”. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet.

Neni 8 “Autorizimi i propozimit për BID-in”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet.

Neni 9 “Prospekti BID-in”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet.

Neni 10 “Procedura e njoftimit për BID-in”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet.

Neni 11 “Miratimi i BID-it”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet me 1 abstenim.

Neni 12 “Regjistrimi i organizatës BID”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet.

Neni 13 “Afatet dhe dokumentet e tjera operationale të organizatës BID”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet.

Neni 14 “Burimet e financimit të organizatës BID”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet.

Neni 15 “Kuota BID”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet.

Neni 16 “Përjashtimet e veçanta të zbatueshmërisë për organizatën BID”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet.

Neni 17 “Të drejtat dhe detyrimet e organizatës BID dhe të paguesve të kuotës BID”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet.

Neni 18 “Të drejtat dhe detyrimet e bashkisë”.

Më falni, se këtu kam një vërejtje: te pika 1, germa “a”: “Të kalojnë në organizatën BID deri në muajin e dytë të vitit kalendarik përkatës financimet e parashikuara shprehimisht sipas marrëveshjes operationale”, pra bëhet fjalë për detyrimet financiare të bashkisë, kur ajo ka rënë dakord, dhe është e detyruar t’i kalojë brenda 2 muajve të para të vitit. Kam një vërejtje nga Shoqata e Bashkive, pra përcaktimi prej 2 muajsh është disi i shkurtër, kështu që do të ishte mirë ose të lihej pa afat sipas detyrimeve në marrëveshjeje, ose të lihej një afat 6-mujor. Si thua, Manjola?

Kështu që po e hedh në votë nenin 18, me propozimin që afati nga 2 muaj të bëhet 6 muaj, sepse në 2 muajt e parë bashkitë merren me miratimin e buxhetit dhe ndoshta nuk janë gati. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Arlind Çaçani nuk merr pjesë në votim

Miratohet neni 18 me një ndryshim në pikën 1, germa “a”.

Kreu IV Palët e interesit” fillon me nenin 19 “Pronat që nuk përdoren në zonën BID”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet.

Neni 20 “Pronat BID që nuk janë të regjistruara”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet.

Neni 21 “Të drejtat dhe detyrimet e banorëve të BID-it dhe palëve të tjera të interesit”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet.

Kreu V “Përfundimi dhe shpërndarja” fillon me nenin 22 “Përfundimi BID-it dhe i organizatës BID”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet.

Kalojmë te kreu VI “Dispozita kalimtare dhe përfundimtare”.

Neni 23 “Vazhdimësia e shoqatave ekzistuese BID”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet.

Neni 24 “Aktet nënligjore”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet.

Neni 25 “Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas votimit në Fletoren Zyrtare”. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet.

E hedhim në votim në tërësi projektligjin “Për përmirësimin e zonave të biznesit (BID)”. Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? 1 abstenim.

Miratohet në tërësi.

Falënderoj zëvendësministren Ikonomi për të gjithë prezantimin dhe për përgjigjet e pyetjeve!

Gjithashtu, falënderoj përfaqësuesit e Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, por edhe kolegët e komisionit!

Kjo ishte pika e fundit në rendin e ditës së sotme. Kështu që me këtë votim e mbyllim mbledhjen e sotme. Mbledhja e radhës do të jetë në fillim të javës që vjen dhe do t'ju njoftojmë, pasi të dalë grafiku përkatës.

Faleminderit dhe mirupafshim!

Mbledhja mbyllet.

**MBYLLET MBLEDHJA**